



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gilan Belediyesi

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e Dytë (II) të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, më datë 29.2.2016 me këtë

REND PUNE

1. **Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar.**
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1. Raporti i punës Janar-Dhjetor 2015 i Kryetarit të Komunës
 - 2.2. Propozim vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2014 dhe 2015, në vitin fiskal 2016
 - 2.3. Propozim vendimi për garancion të qëndrueshmëris operative dhe financiare për Ndërmarrjen në themelim “Tregu” në Gjiçan
 - 2.4. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës “Hendikos” në Gjiçan
 - 2.5. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Qendrës për kujdesin ditorë “Pema” në Gjiçan
 - 2.6. Propozim vendimi për Qasjen e ndërrimit të destinimit-Revidimit të një pjesë të Planit të Hollësishëm Urban: ” Kodra e Thatë” (QKMF)
 - 2.7. Propozim vendimi për Qasjen e ndërrimit të destinimit-Revidimit të një pjesë të Planit Zhvillimor Urban: ” Qyteti i Gjiçanit” (Shtëpia për të moshuarit)
 - 2.8. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për nevoja të ndërtimit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjiçan.
 - 2.9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për nevoja të ndërtimit të “Shtëpisë për të Moshuarit” në Gjiçan.
 - 2.10. Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të objektit arsimor- shkollë fillore sipas PRRU “Dheu i Bardh-2” – Gjiçan
 - 2.11. Propozim Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
 - 2.12. Propozim Plani për ndryshimin dhe plotësimin e Planit të veprimit për transparencë, 01.Nr.016-58781 i dt.27.05.2014
 - 2.13. Rishikimi i Vendimit për ndryshimin e Projektit të Lumit “Mirusha” dhe Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale (sipas sugjerimit të MAPL)

3. Të ndryshme.

Në punimet e seancës së dytë morën pjesë;

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Zv/kryetari i Komunës, Rexhep Kadriu

Përfaqësuesja e OSB-së, Sadete Ternava

Përfaqësuesi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, z. Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i OJQ "Lansdowne". Shaban Terziu

Mediet

Seancën e dytë të KK-së e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesja e Kuvendit, zonja Valentinë Bunjaku e cila i përshëndeti të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit e tjerë në seancë.

Në vijim kryesuesja, kërkoi që para se të miratohet rendi i punës, propozoj që të miratohet procesverbali.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit ishin të pranishëm në sallë.

Fehmi Sylejmnai- para se të fillojmë me rendin e punës dhe aprovim të procesverbalit, unë kërkoj për ta ditur, pse gjendet në këtë seancë anëtari i Kuvendit nga komuniteti serb, z. Sergjan Mitriç? Ne për këtë anëtarë kemi votuar dhe e kemi përjashtuar për arsyeje të njohura dhe tash nuk kemi asnjë informatë se i kanë rrjedh procedurat e mëtejme dhe pse ai përsëri gjendet në seancë?

Leonorë Bunjaku- në çdo seancë kërkohet aprovimi i procesverbalit të kaluar, prandaj unë kërkoj nga procesmbajtësi që t' i përfshijë të gjitha gjërat e rëndësishme dhe mos të tejkalohen debatet që përfshihen këtu siç janë: fyerjet, fjalët e urta, metaforat, kërcënimet e kështu me radhë. Procesverbali i seancës së kaluar është i mangët, prandaj kërkoj nga procesmbajtësi pse nuk është protokolluar debati i kaluar?

Riad Rashiti- edhe unë të njëjtin shqetësim e kam sikur zonja Leonorë, sepse nuk është përfshirë fjala ime për çështjen e arsimit.

Sqarim nga procesmbajtësi- në seancën e kaluar ka pasur një debat (dialog) në mes zonjës Leonorë dhe drejtorit të Arsimit, e që ka filluar në holin e sallës së Kuvendit gjatë një pushimi të shkurtër dhe ka vazhduar në seancë, prandaj kur nuk flitet sipas radhës dhe bëhet dialogë, është e pamundur që të përfshihen në procesverbal. Me respekt zonja Bunjaku, nuk kam bërë asgjë me tendencë.

Aprovohet procesverbali i seancës së kaluar me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit me vërejtjet e dhëna.

Hapet debati për rendin e punës:

Avdyl Aliu- unë propozoj në emër të grupit të anëtarëve të LDK-së që të bëhet një ristrukturim i pikave të rendit të punës për hir të efikasitetit të Kohës. Për shkak se disa pika kanë ngjashmëri dhe gati të njëjtën çështje, prandaj të debatohen si një pikë e që janë: pika 2.4 dhe 2.5, por të ngjashme janë edhe pika 2.6 dhe 2.7, mandej edhe pika 2.8 dhe pika 2.9.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- kush është i pajtimit që të debatohen si një pikë: pika 2.4 dhe 2.5, mandej 2.6 dhe 2.7 dhe 2.8 dhe 2.9, ashtu siç propozoi z. Aliu?

Sahit Abazi- ne propozojmë që kjo seancë të ndahet në dy pjesë, sepse ka një numër të madh të pikave, por edhe sikur të aprovet edhe propozimi i shefit të grupit të LDK-së, përsëri ka shumë pika dhe përsëri kjo seancë do të zgjas deri pas dite.

Propozimi i dytë është që ne shefat e grupeve ta mbajmë një takim para se të fillojmë me rendin e ditës ta kemi një pushim për arsye të rastit që e përmendi kolegu nga LVV, z. Sylejmani për rastin e anëtarit të Kuvendit nga minoriteti serb.

Propozimi i parë është që ta ndajmë seancën në dy pjesë, sepse është e stërngarkuar

Fehmi Sylejmnai- unë pajtohem me këtë pjesën e parë që e propozoi z. Sahiti, kure sa i përket rendit të punës, propozoj që pika 2.8 të hiqet, sepse kemi propozime tjera se ku duhet të vendoset QKMF-ja. Mandej nuk është bërë ndonjë debat me qytetarë për këtë rast se ku është vendi më i përshtatshëm ?

Sipas juve kjo QKMF, është paraparë që të ndërtohet te ish Magjistratja në një sipërfaqe prej 30 ari e që mendoj se kjo logjikisht nuk është në rregull, sepse aty shumë afër është spitali dhe të gjithë pacientët do të shkojnë në Spitalin Regjional, kurse QKMF-ja në atë vend nuk do të ketë pacientë.

Propozimi i im është që QKMF të ngritet aty ku ka qenë Eco-Higjiena, por edhe më mirë do të ishte që në ish objektin ku ka qenë kryetari, të rrenohet në tërësi dhe t' i epet në pronësi QKMF-së, sepse është një ndër lokacionet më të përshtatshme.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- para se ta hedhim në votim propozimin e z. Aliu, kërkoj 5 minuta pushim për t' u konsultuar me shefat e grupeve.

Pas 5 minutave vazhdon seanca, kurse kryesuesja kërkon që të deklarohen anëtarët e Kuvendit se kush është për propozimin e shefit të grupit të LDK-së sa i përket rendit të punës?

Aprovohet propozimi i z. Aliu me 21 vota të anëtarëve, kurse 8 ishin kundër dhe të tjerët abstenime.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- në konsultim me shefat e grupeve dhe në bazë të nenit 26, paragrafi 27 të Rregullores për punën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit është marrë vendim për përjashtim nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, z. Sergjan Mitroviç.

Përjashtim i z. Sergjan Mitroviç bëhet me kërkesë të anëtarëve të Kuvendit, sepse i njëjti është emëruar nga Qeveria Serbe në pozitën e ushtruesit të kryetarit të organit të përkohshëm i të ashtuquajturit të Komunës së Gjilanit me seli në fshatin Kuscë, si strukturë paralele e Qeverisë Serbe e instaluar në Komunën e Gjilanit.

Obligohen organet komunale që në bashkëpunim me MPL dhe Komisionit zgjedhor t' i marrin veprimet për zëvendësimin e z. Sergjan Mitroviç në pozitën e anëtarit të Kuvendit me një person tjetër nga i njëjti subjekt politikë.

Kush është që nga kjo seancë të përjashtohet z. Segjan Mitroviç, sepse ka shkaktuar rrëmujë dhe parregullsi në sallë në këtë seancë.

Aprovohet kërkesa e kryesuese dhe të gjithë anëtarët e Kuvendit, ishin të pajtimit që z. Segjan Mitroviç ta lëshojë sallën e Kuvendit.

Z. Mitroviç, hamendej dhe nuk e mori fjalën dhe dy-tre minuta qëndroi në sallë, kurse kryesuesja i liroi anëtarët e Kuvendit 10 minuta në pushim.

Pas 10 minutave seanca i filloi punimet normalisht, sepse z. Mitroviç nuk u kthye në sallë.

2.1 Raporti i punës Janar-Dhjetor 2015 i Kryetarit të Komunës

Lutfi Haziri- të nderuar anëtarë të Kuvendit, të nderuar drejtorë, kryesuese dhe ju monitorues të kësaj seance të Komunës së Gjilanit. Më lejon që ta shfrytëzoj këtë mundësi që sipas ligjit në harmoni të plotë me kompetencat e kryetarit të Komunës dhe me qëllim të ngritjes së transparencës në Komunë ta ofroj sot raportin e punës me qëllim të dhënies së informatave më të detajuara përkitazi me punën e ekzekutivit të Komunës së Gjilanit. Ky raport vjetor vije si pasojë e raportit periodik gjashtë mujor e që e kemi paraqitur gjatë vitit 2015 dhe raporti nëntë mujor të paraqitur me shkrim para Kuvendit i cili raport përfshin angazhimet e drejtorëve dhe të zyrave në varësi të kryetarit të Komunës.

Në vijim të fjalës së tij, kryetari vazhdoi për ta elaboruar raportin e punës, por anëtarët e Kuvendit këtë raport e kanë me shkrim në materialet e tyre.

Avdyl Aliu- më lejoni që të shprehi mirënjohje për këtë raport të kryetarit të Komunës qëllimi i të cilit është që para Kuvendit të paraqes punën e Qeverisë Komunale për vitin 2015. E kemi përpara një raport të përgatitur mirë si në aspektin teknik ashtu edhe përmbajtësor. Raporti paraqet një përmbledhje të zhvillimeve kryesore gjatë periudhës njëvjeçare të vitit 2015. Qëndrimi i jonë si grup i këshilltarëve përkitazi me raportin është i ditur, sepse në mënyrë sistematike kryetari në çdo tre mujor ka raportuar para neve lidhur me punën e Qeverisë Komunale, prandaj për neve është i njohur ky raport dhe ne i kemi dhënë vlerësim për ¾ e vitit, kurse sot ka mbetur për ta plotësuar vetëm për një çerek viti ose ¼ e kësaj periudhe.

Edhe kjo përdhë për ne sikurse edhe ato tri të tjerat paraqet ngritje dhe avancim në të gjitha drejtoritë, njësitë dhe zyrat dhe sipas neve ka rritje të rezultateve dhe të përformancës. Edhe në këtë periudhë me këto zhvillime kryetari i Komunës është në drejtim të duhur të përmbushjes së kërkesave të qytetarëve të Komunës së Gjilanit dhe kemi stabilizim të gjendjes, ngritje të dukshme të cilësisë së punëve në të gjitha drejtoritë, njësitë dhe zyrat dhe të gjitha janë në funksion të përmbushjes dhe nevojave të qytetarëve.

Në raport shihet se vazhdohet me ulje të shpenzimeve në të gjitha drejtoritë edhe përkundër faktit se janë në rritje e sipër. Në aspektin e përgjithshëm kryetari i Komunës ka bërë një angazhim të kënaqshëm gjatë këtyre 12 muajve dhe atë duke u bazuar në kompetenca të plota që i jep ligji. Edhe pse me një buxhet modest, vërehet një angazhim i kryetarit dhe drejtorëve në përmbushje të nevojave të qytetarëve siç i përmendi kryetari ujesjellësit, kanalizimet dhe asfaltimet e rrugëve dhe nevojat e tjera të qytetarëve. Duhet theksuar rezultatin e punës së kryetarit dhe ekipit të tij në aspektin humanitar dhe i cili po vazhdon me sukses, duke përruruar shumë shpesh shtëpi për skamnor, duke meremetuar të tjera, duke shpërndarë pako ushqimore, higjienike dhe të tjera ndihma dhe e tëra kjo bëhet për t'ia përmirësuar jetën familjeve të varfra dhe me nevojë e që fatkeqësitë familje të tilla ka ende shumë dhe nuk kalon një ditë e vetme që mos të lajmërohet dhe regjistrohet një e tillë (raste të reja).

Është një përkushtim që ky aksion të vazhdojë edhe më tutje dhe ky përkushtim është shpresë për nevojtarët e tjerë, por ne do të vazhdojmë për të ndihmuar edhe në vazhdim. E tërë kjo do të kishte qenë vështirë të realizohet po të mos kishim edhe vullnet të dhuruesve si vendor ashtu edhe të jashtëm e të cilët kanë shprehur gatishmërinë për të vazhduar me aksione të tilla. Për këtë humanitet të dhuruesve e shfrytëzoj rastin për t'ia falënderuar dhuruesit në emër të Kuvendit për këtë gatishmëri. Punët që janë thënë në këtë raport janë të dukshme kush ka dashur për t'parë dhe ato shihen çdo ditë. Pas raportimit të kryetarit, nuk duhet të shqetësohet as kryetari dhe askush tjetër, sepse sado që të jetë raport i mirë nuk ka asgjë të keqe të komentohet nga kolegët anëtarë të Kuvendit, por edhe nga qytetarët, shoqëria civile dhe grupet e interesave të ndryshme.

Sa për informim po theksoj se nëpër disa medie dhe disa opozitar ka pasur një kërkesë që kryetarit t'ia ndërtohet një aeroport në Gjilan, por besoj se nuk është ide e keqe dhe besoj se edhe kryetari e ka në prioritet ndonjëherë ta realizoj këtë “dëshirë” të këtyre medieve, sepse nuk ka asgjë të keqe në këtë propozim që Gjilani të ketë një aeroport. Unë kësaj kërkesë ia shtoj edhe një tjetër që kryetari ta hap një shkollë kudo që të mësojnë ata që kanë nevojë prej asaj se si duhet, reklamuar biletat e fluturimit, se si duhet të hyjnë në aeroplan për t'ia kaluar

kufijtë edhe jashtë Llabjanit. Efektin e këtyre fluturimeve të shpeshta të kryetarit besoj se do ta shohim në këto dy vite në vazhdim gjatë vitit 2016 dhe 2017. Është varfëri për një kryetar që të merret vetëm me buxhetin komunal dhe ai buxhet i tatim paguesve harxhohet vetëm në pleskavica dhe biftekë.

Në emër të grupit të këshilltarëve ne e vlerësojmë lartë këtë raport dhe këtë vullnet të mirë të kryetarit dhe e inkurajojmë kryetarin që edhe më tutje të vazhdojë me punë të mira, por gjithnjë duke dëshiruar që të ketë punë edhe më të mira, sepse ka vend edhe për punë më të mira.

Në emër të anëtarëve të LDK-së ne e votojmë raportin e kryetarit Haziri për periudhën janar – dhjetor për vitin 2015.

Riad Rashiti- para se të flas për raportin më nxiti kolegu im i dashur për të thënë se e dimë që LDK-ja tash e ka besimin shumë më të madh për ta qeverisë Komunën e Gjilanit, sepse e ka përkrahur një president më të mirë që e ka Kosova dhe aftësia e tij dhe menaxhimi i tij i ka sjell shumë investime Kosovës, duke ndërtuar autostrada dhe kryetari i Komunës e ka një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me Hashim Thaqin dhe do ta paraqes këtë projekt qoftë në Llovcë ose kudo tjetër. Sa i përket shkollës, kjo ide është e mirë, por është mirë që në këtë shkollë të shkollohen ata që janë të pashkollë, kurse ne si opozitë i kemi kryer 6 vjet studime dhe 2 vite i kam pasur në Slloveni dhe është mirë ta vizitojë Slloveninë dhe pastaj ta kryeni magistraturën në Slloveni.

Sa i përket raportit u thanë të gjitha të mirat këtë dhe pjesërisht ka disa të mira këtu, por për të mira nuk ka hapësirë, por dua të fokusohem në emër të PDK-së për tri shtylla të këtij raporti.

Së pari u përmendën investimet të cilat nuk qëndrojnë absolutisht në ato që raportojë kryetari i Komunës, por kjo nuk qëndron edhe për shpenzimet. Për ne ky raport nuk ka përmbajtje cilësore, është një raport sa për t' i mbuluar dështimet totale që i ka pasur kjo qeverisje komunale për këto dy vite.

Unë nuk e pash dhe nuk e tha kryetari i Komunës se cilin projekt të vetëm e ka ideuar? Ide të kryetarit që ka gjet fonde, që i ka realizuar një projekt nuk ka, të gjithë shiritat që i keni prerë deri më tash dhe do të vazhdoni deri në mandatin e juaj, do të vazhdoni t' i preni të cilët kanë filluar nga qeverisja e PDK-së. Në këtë raport nuk janë paraqitur problemet, nuk janë paraqitur sfidat, nuk janë pengesat dhe vështirësitë dhe të gjitha këto janë probleme serioze me të cilat ju si qeverisje jeni përballë për këto dy vite.

Ky koalicion i juaji që e keni aktualisht është pak më i vogël se i elefantëve dhe i ka sjell Gjilanit, kaosin e viteve 2006-2007. Kemi çrregullim total të qeverisjes komunale, kemi degradim institucional, kemi konflikte të mëdha dhe të shumta ligjore, kemi rritje të korrupsionit e të cilin ju nuk e pranoni. Kemi keqpërdorime të mëdha të buxhetit komunal dhe të donatorëve, keni bërë politizimin e skajshëm të qeverisjes përmes të cilave e keni dëmtuar edhe buxhetin komunal, sepse zyrtarët të cilët i keni larguar nga puna ata po kthehen me vendim të gjykatës, kurse ju jeni të obliguar t' ia paguani dëmet që ia keni bërë këtyre punëtorëve.

Ky koalicion po shihet edhe nga LDK që nuk ka përkrahje dhe po shihet se po ka funksionim normal të institucioneve. E çmoj këtë kundërshtim të LDK-së që vjen për koalicionin në Gjilan.

Kryetari para se të vijë në qeverisje ka premtuar shumë se do të vijë me duar të pastra, por a jeni duke qeverisur me duar të pastra, unë do t' i jap disa argumente.

Muajin e kaluar janë ngrit aktakuza nga Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzë ndaj zyrtarëve më të lartë komunal, ndaj drejtorit, kurse kryetari ende e mban në pozitë. Kam pyetje se çfarë masa keni ndërmarrë dhe pse nuk ndërmerrni masa disiplinore ndaj tij e që je i obliguar për të ndërmarrë. Po ashtu para pak ditëve është ngrit një aktakuzë tjetër ndaj një zyrtari të aksionarëve Komunal të Ndërmarrjes Publike Eco- Higjiena e të cilin e kai emëruar personalisht kryetari. E keni sjell propozimin në Kuvend dhe e keni miratuar. E dini mirë se ne e kemi tërhequr vërejtjen se ky anëtar nuk mund të jetë i pranueshëm, sepse ka konflikt ligjor me atë kompani, por ju e keni përkrah këtë shkelje dhe ju e mbron dhe e keni emëruar edhe në borde dhe në komisione të ndryshme e të cilët kanë pasur konflikt ligjor. Agjensioni Kundër Korrupsionit në këtë kohë ka konstatuar dhe i ka anuluar 6 tenderë dhe dy i ka anuluar këtë muaj për shkelje ligjore e të cilat po i bën Zyra e Prokurimit.

Po e përmendi projektin e Çerdhes së fëmijëve në Dardani e në të cilin projekt e keni keqpërdor dhe e keni shkel ligjin. Është donacion 200 mijë € i USAID-it dhe ky anulohet për shkak të shkeljeve ligjore.

Po ashtu javën e kaluar Agjensini Kundër Korrupsionit anuloi tenderin për blerjen e aipedëve, sepse ka konstatuar se janë bërë shkele ligjore, sepse ka qenë e nevojshme të blihen 35 aiped, kurse kërkesa është bërë për 50 copë.

Agjensioni ka ngrit shqetësim, pse janë porosit 15 aiped më tepër se sa nevoja që ka qenë. Jo vetëm Agjensioni Kundër Korrupsionit, por edhe OSHP i ka anuluar 24 tenderë në vlerë prej 15 milion €, për këto dy vite. A nuk

është shqetësuese kjo për juve që vazhdoni ende me të njëjtën mënyrë ta qeverisni Komunën dhe buxhetin e Komunës?

Dikush është përgjegjës për këto shkelje, sepse 24 OSHP, 6 Agjensioni Kundër Korrupsionit dhe për 15 milion € keni bërë shkelje ligjore. A ka shkelje apo jo hetimet po vazhdojnë, por jo për të kaluarën, por për të tashmen. Unë e di që në të kaluarën asnjë aktakuzë nuk është ngritur për 6 vjet. Për juve për dy vite 6 aktakuza janë ngritur, por priten edhe aktakuza të tjera në vazhdi, Nëse kësaj i thonë se keni qeverisur me duar të pastra, atëherë unë nuk e kuptoj gjuhën tënde? Kjo qeverisje e juaj i ka zhytë shumë thellë duart qoftë në ndërtimet pa leje që e keni bërë kos kaos Komunën e Gjilanit dhe nuk e thatë asnjë fjalë se çka keni bërë ju si kryetar i Komunës për ta ndal këtë dukuri shkatërruese që po bëhen në qytetin e Gjilanit. Për që ka parregullsi z. kryetar edhe vetë e keni pranuar, sepse keni kërkuar që t'i bëhet auditimi Drejtorisë së Arsimit, për të cilin rast ne vazhdimisht e kemi ngritur shqetësim se aty ka punësime të paligjshme dhe ka shkelje ligjore të mëdha, por mirë keni bërë që e keni bërë këtë kërkesë dhe është i vetmi veprim që e keni bërë, e keni bërë te arsimi. Mirëpo nuk mendoj nuk keni bërë kërkesë për ta audituar këtë arsim për vënë në rend, por për shkak që nuk iu kanë kryer punët sipas dëshirave të tua, sepse ka qenë desh të kërkonit auditim edhe te Urbanizmi dhe Prokurimi, por aty nuk keni bërë kërkesë. Keni bërë kërkesë te Arsimi, sepse nuk janë kryer punët sipas urdhrave tua. Këtë gjendje të anarkisë në raport tuajin keni pasur guxim se gjëja keni pasur progres në Gjilan. Keni thënë disiplinë fiskale dhe të hyra komunale të rritura, por asnjëra nuk është e vërtetë. Te të hyrat komunale thoni se ka pasur rritje, por një raport që e kemi sot i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa thotë se ka pasur rënie, kurse ju thoni se ka pasur rritje. Cila është e vërteta? Më 2014 janë bërë 3 milion e 698 mijë € të hyra, ndërsa këtë vit janë 3 milion e 627 mijë dhe ka zbritje për 70 mijë €, kurse ju e quani rritje.

Unë e kam problem për ta kuptuar gjuhën që e përdorni ju, ashtu sikur që keni thënë ne i kemi ulur taksat dhe bizneset, por e vërteta është se ju i keni rikthyer taksat dhe i keni rrit. Edhe sot e kemi një rregullore ku keni paraqitur taksa të paligjshme për t' i rënduar bizneset dhe jo për t' i lehtësuar. Ndërsa tek investimet kapitale me përgjegjësi në emër të grupit po e them se ju keni dështuar plotësisht dhe aq e turpshme është që të mos shfrytëzohet edhe ky buxhet i vogël që ka qenë për Gjilanin. Ne kemi siguruar informacione nga ministria, sepse drejtoritë nuk na kanë dhënë informacione dhe ju e thatë se ka pasur të hyra vetanake për pa u shfrytëzuar (suficit). Një milion e 4 mijë €, keni suficit vetëm sipas informacioneve tona për grande që kanë qenë për rregullimin e infrastrukturës në fshatra dhe në qytet, kanë qenë të planifikuara 2 milion 400 mijë €, kurse 700 mijë € iu kanë mbet suficit.

Grandet e donatorëve të KE-së USAID-it janë mbi 150 mijë € që nuk i keni shfrytëzuar të gjitha dhe që kanë qenë të planifikuara. Nga fondi humanitar e kam ngritur si shqetësim dhe prapë po e ngris nuk janë shfrytëzuar të gjitha mjetet dhe kam pyetje pse nuk shfrytëzohen 200 mijë € edhe pas 20 muajve. Sa i përket investitorëve të huaj e keni përmendur Austrinë, por asgjë konkrete nuk ka, ndërsa kontratën e cila është valide dhe i keni vënë 1 milion euro investime me partnerin Austriakë me Eco- Higjienën e që ka pasur kontratë me PPP, ka qenë i obliguar t' investojë partneri Austriak t' i investojë 1 milion euro në këtë kompani, kurse ju këto i keni bllokuar. Kur mblidhen të gjitha këto del 3 milion euro në projekte të cilat nuk i keni investuar në projekte të cilat kanë qenë të planifikuara dhe ka pasur fond për këtë buxhet, por është dështim total dhe është turp ajo se çka po ndodh!? Ju as nuk mundeni as nuk dini as nuk keni vullnet, as nuk keni njerëz për t' i menaxhuar këto projekte për realizim dhe investim.

Ne e dimë se ne këto që po i themi se nuk i pranoni, sepse jeni mësuar për ta mohuar realitetin dhe deklaroni shumë të pavërteta, shumë herë me qëllim për ta mashtruar opinionin se komuna e Gjilanit po punon dhe ka dhurues, por këto janë vetëm fjalë të fushatës elektorale. Unë nuk po e kuptoj kryetarin se si po mendon neve për të na mashtruar dhe si del këtu dhe thua unë e kam debllokuar projektin e bibliotekës së qytetit dhe kjo absolutisht është një e pavërtetë shumë e madhe. Këtë projekt e ka financuar KE i cili e ka bërë edhe projektimin e ka bërë tenderimin, kontraktimin dhe e ka bërë mbikëqyrjen. Mirëpo problemet që kanë qenë ato janë në mes të KE-së dhe të Kompanisë së kontraktuar e cila ka bërë dollovere me këtë projekt e që është bllokuar para dy vite e gjysmë. Ju nuk keni pasur mundësi asnjë milimetër për ta debllokuar, pse po mundohesh të na mashtrosh, cili është hapi i yt për ta debllokuar këtë projekt. Mos na flisni këso gjëra që dy vite dhe nuk mund më t' i durojmë këtu fjalët të cilat nuk qëndrojnë me asgjë. Ndërtimi i çerdhes në Dardani për të cilin USAID-i ka premtuar donacion në vlerë prej 200 mijë €, po pyes pse nuk është nisë? Nuk po nis për atë që e

thash më herët, sepse ka tenderë me dolloverëve, shkelje ligjore dhe këtë vendim për këtë projekt e ka anuluar Agjensioni Kundër Korrupsionit e që e thash më herët.

Projektin e Stadiumit të Vogël që e përmende nuk është realizuar fare nga ju, por ju mund të shkoni vetëm për ta prerë shiritin, sepse këtë projekt e ka bërë qeverisja e PDK-së, donacionin e ka gjet qeverisja e PDK-së, tenderimin e ka bërë qeverisja e PDK-së, kontaktimin e ka bërë PDK dhe është donacion i KE-së, kurse kontributi i kryetarit është vetëm për ta prerë shiritin dhe kaq është kontributi i juaj.

Në përgjithësi investimet që i keni bërë, kur iu dëgjojmë juve është shumë i mirë dhe kur keni qenë në panairin e Zvicrës e keni krahasuar Gjilanin me Barcelonën. Unë nuk e di pse kryetari e ka krahasuar Gjilanin me Barcelonën. por një e di që në aspektin e shpenzimeve enorme që janë bërë për pjesëmarrjen tuaj dhe të plotë zyrtarëve komunal që kanë shkuar për turizëm, sepse i keni shpenzuar 30 mijë € në atë vizitë dhe asgjë dhe asnjë projekt prej atij takimi nuk ka ardhur. Në raportin e kryetarit thuhet se Gjilani po nxirret nga balta dhe po e lidhni me autostradën ndërkombëtare, por këto janë deklarata më shumë se qesharake, sepse e dinë mirë ti kryetar se në këtë vit zero euro ka buxhet të planifikuar për autostradë. E dinë se në kornizën afatmesme të kornizës buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës zero euro nuk janë ndarë për autostradë. Nuk ka para për autostradë po flisni kot.

Baltën nuk e keni hequr në qytetin e Gjilanit, por fatkeqësisht ndotësirat kanë dalë në sipërfaqe të Gjilanit, sepse Lumin Mirusha e keni lënë në gjendje të mjerueshme, sepse verës dalin gjarpinjtë, kurse në dimër bëhen vërshime dhe punë nuk keni bërë dhe buxhet nuk keni bërë. Arsyetoheni se do të ketë ndryshime projekti kjo është e vërtetë, sepse në seancën e kaluar është prezantuar një projekt këtu dhe ne kemi thënë se është i jashtëligjshëm, sepse është konflikt interesi, sepse projektin e ka bërë projektuesi dhe është i kontraktuar dhe është dashtë Komiteti për Urbanizëm për ta marrë vendimin, por këtë vendim e ka marrë kryetari dhe propozimi ka qenë për ta mbuluar lumin me beton dhe jam i informuar se Ministria e Ambientit e ka anuluar dhe ka kërkuar shqyrtimin e vendimit që e kemi sot në seancë, sepse nuk është respektuar procedura ligjore.

Sa i përket shpenzimeve e thatë se kemi disiplinë të ashpër buxhetore, por unë nuk e di çfarë discipline dhe kujt i thoni ju disiplinë, sepse nëse flisni për total keni bërë rritje e sidomos në tender të ndryshëm e të cilin rast e kam theksuar edhe në seancën e kaluar dhe po e përsëris prapë. Si mund të quhet disiplinë buxhetore, kur tenderi për shërbime rritet 10 fish në krahasim me vitin e kaluar dhe jo vetëm 100% , por 1000% ka rritje të tenderëve.

Te transporti i nxënësve jemi akuzuar ne pse kemi bërë shpenzime enorme, kurse ju e keni rrit vlerën për 146 mijë euro transportin e nxënësve, kurse nafta ka ra në 0.80-0.90 euro, kurse kur ne ishim në qeverisje ka qenë 1.30 euro dhe ju në vend se t' i ulni. Ju z. kryetar i keni shpenzuar 15 mijë euro për vizita turistike, keni marrë mbi 4.600 euro mëditje dhe keni shpenzuar mbi 6 mijë euro për akomodim jashtë vendit dhe pagesa të ndryshme që janë bërë përmes kredi kartelës në llogari bankare jashtë vendit dhe këto e në total janë shpenzuar z. kryetar mbi 26 mijë euro. Mesatarisht për çdo muaj keni harxhuar mbi 2.200 euro dhe a është kjo dietë z. kryetar?

Përfundimisht e vlerësojmë raport të dështuar dhe problemet nuk keni qenë të gatshëm për t' i trajtuar dhe për t' i zgjidhur.

Lutfi Haziri- nuk e kam ndërmend të merrem me diskutime, por e kam ndërmend për të dëgjuar dhe për t' i marrë parasysh ato që vlejnë për t' i marrë parasysh. Unë nuk dëgjova këtu debat, por dëgjova monolog. Monolog i cili e shtron vetë çështjen dhe përgjigjet vetë. Praktikisht nëse dëshirojmë për të folur për çështje të caktuara ose debatojmë me çështje konkrete, është ky raport është konkretë. Viti ka shkruar populli thotë :

“ pitja është ngrënë, kure tepsia ka mbet”. Po më detyroni që të them diçka e që nuk është deshtë të thuhet asnjëherë dhe dëshiroj që ta konfirmoj se unë dhe ekipi im dhe përfaqësuesit e partisë që unë i udhëheq si degë në Gjilan nuk merren me dosje dhe nuk jemi marrë. Mirëpo po iu konfirmoj se kam informatë zyrtare se 17 programe me 30 vetë zyrtarë janë përfshirë për shkelje të rënda. Nuk përzihem në këto punë dhe nuk më intereson se kush është dhe sipas informatës zyrtare ka lëndë edhe të vitit 2013, ndaj tre zyrtarëve, njëri prej të cilëve është emëruar drejtor.

Aktakuzën e ka me emër dhe mbiemër për ndërtesën e investitorit të Agron Morinës i lejuar për të bërë mbindërtim. Kjo është përgjegjësia e tij, sepse si drejtor i Inspeksionit nuk ka ndërhyrë në këtë mbindërtim. Kur është ndërtuar ndërtesa, në cilin vit është ndërtuar dhe në cilën kohë është bërë mbindërtimi? Nuk është mirë të

mundohemi për të gjetur të bëjmë probleme ose të bëhemi zgjedhës i problemit duke dashur problemet e tua t' i nxjerr në taborin tjetër.

Nuk është mirë të thuhet se kryetar ke harxhuar bileta, sepse biletat e vitit 2012 dhe 2013 duhet t' i paguajmë tash.

Nuk është mirë të thuhet se kryetari Haziri ka harxhuar roming, sepse roming të ish nënkryetarit dhe kryetarit jam duke paguar tash. Sa ka kushtuar servisimi i borxheve, listat janë dhe mund të verifikohet se Lutfi Haziri nuk i ka kaluar mbi 20 euro në muaj harxhime të telefonit dhe kjo është marrëveshje e pakos sikur çdo zyrtarë tjetër që është përfshirë në vala. Ato mund të verifikohen, sepse me numra janë, por marrëveshjet me operatorët të cilat i kemi bërë na obligojnë për ripërmbarimet dhe përmbarimet është desh të hyjmë në servisim. Është krejt në rregull për të thënë se ka ndodhur ky përmbarim dhe faleminderit që po e servisoni. Edhe sipas detyrës zyrtare është deshtë për t' ia hequr borxhlinjtë nga dera dikujt. Borxhet e këqija mbani në mend, angazhim i madh ka qenë desh për t' u realizuar mbështetje donatorëve, sepse një organizatë buxhetore, sikurse që është Kuvendi Komunal i Gjilanit i cili ka borxhe të këqija nuk mund të merr as mjete nga Qeveria e mos të flasim për donatorë, sepse llogaritet organizatë e cila ka menaxhim të keq të financave. Kemi arrit me disiplinë të ashpër dhe jo me kërkesë tonë, me auditim me kontroll, ata nuk kanë ngjyra politike dhe ku ka qenë keq i thuhet keq dhe ky është roli i auditorit dhe do të marrim masa për ta përmirësuar. Nuk kam ndërhyrë asnjëherë në organe të drejtësisë dhe as që e kam ndërmend për të ndërhyrë, sikurse që nuk kam ndërhyrë në Zyrë të Prokurimit në OSHP dhe KRPP. Asgjë të keqe nuk ka nëse OSHP-ja e trajton lëndën në mënyrën e vetë, mirëpo unë e di shumë saktë se ka pasur ndërhyrje edhe prej Gjilanit në OSHP. Unë nuk luaj me fjalë se kush ke po e mund, por kërkoj argumente. Lagjja "Dardania" është në kuadër të ndërtimit "Kosova e Bukur". Kjo lagje ka qenë e planifikuar për ndërtim të lartë dhe qendër tregtare në mjedis të lagjes. Ne e kemi ndryshuar kemi ndërtuar park dhe banorët e asaj lagjeje e shfrytëzojnë. Shkoni e pyetni banorët e lagjes "Dheu i Bardhë", pyeti fshatrat se a është kontinuitet. Këto po i bie sipas grupit të PDK-së se është në tërësi

E tëra është e PDK-së, por unë ia paskam prishur planet dhe ka rastis në Zyrën e Kryetarit.

E tëra është programi i PDK-së, kultura politike e PDK-së kontinuiteti i PDK-së, buxheti i PDK-së dhe Presidenti tash i PDK-së me ndihmën tonë dhe vetëm unë tash jam gabim. Nëse unë iu kam zënë rrugën më vjen keq dhe shumë keq, por unë rrugë nuk i kam zënë askujt dhe jam ardhur me votë qytetare. Nëse mendoni se ka qenë krejt mirë, atëherë duhet të mendoni se nuk ka qenë mirë, sepse i keni humbur zgjedhjet. Nëse ka qenë mirë unë nuk kërkoja mirëkuptim dhe dua të më shkoni në sy kur të flasim për këto punë. Nuk po kërkoj mirëkuptim, sepse e di që ne nuk mirëkuptohemi, sepse jemi dy parti të ndryshme jemi rivale dhe nuk do të mirëkuptohemi kurrë dhe as që do të mirëkuptohemi. Për diçka që ne duhet të mirëkuptohemi është ligji dhe ai është i njëjtë për të gjithë dhe vetëm ligji është instrument i cili mund të na dirigjon. Edhe fjala pa mbulesë me ligj është shpifje. Nuk mund të fitojë askush duke bërë akuza të rrejshme dhe duke shpif mbi dike qoftë individ qoftë grup.

Cili është problemi i Eco-Higjienës? Me Eco-Higjienën ne e kemi zbardhë kontratën dhe disa nga marrëveshjet dhe planet janë prish nga kjo qeverisje lokale të cilën unë e udhëheq.

Nuk favorizoj ndërtime të objekteve dhe banesave për qëllime komerciale, nuk i favorizoj programet e PPP-së, sepse interesin kryesor e ka për organizmin e shërbimeve. Eco-higjiena ofron shërbim me një kontratë të disfavorshme për Komunën është nënshkruar ajo marrëveshje dhe në këtë javë e kemi takimin e përbashkët dhe do të vazhdojmë për ta zbardhë. Sipas llogarive tona ne jemi aksionar i madh tash, sepse nuk ka investime nuk iu janë përmbajtur kushteve dhe këtë unë dua ta saktësoj. Mirëpo ju e dini se në preambulë e keni dërguar në Gjykatë të Arbitrazhit zgjidhjen e problemeve në mes të aksionarëve.

Nuk ia kemi dhënë tregun dhe nuk kemi dashur t' ia japim tregun dhe nuk jemi pajtuar që të tregu të jetë pjesë e kësaj marrëveshje, sepse tregu do të ndërtohet në një ndërmarre komunale.

Çerdhja në "Dardani" nuk ka të bëjë me asgjë dhe çerdhja në Dardani ka të bëjë vetëm me rekomandimet e KRPP-së. Pse nuk janë marrë veprime konkrete ndaj zyrtarëve të dyshuar? Mirëpo unë kur ta marrë njoftimin e parë me shkrim nga Prokuroria e Shtetit, unë do ta marrë veprimin e parë zyrtarisht. Aktakuza zyrtare tek unë nuk ka ardhur dhe në momentin e parë që vjen unë me ligj jam i obliguar për t' i suspenduar me pagesë 50%.

Derisa njerëzit nuk janë të fajshëm askush nuk mund t' i suspendojmë me pagesë për ata që i njeh ligji.

Pse kam marrë veprime këtu e atje është çështje dhe mënyra se si ne e organizojmë zyrën. Kaosi qeverisës mund të shihet nga një kënd i cili ka qenë i planifikuar ndryshe dhe po ndodh ndryshe. Ne kemi prishur shumë plane,

unë e di atë, por e dini edhe ju edhe partia dhe grupi juaj e din dhe ne i kemi vendos disa kriter dhe rregulla krejt të tjera, por mund të shihet si kaos, sepse nuk është lejuar që të punohet ashtu siç është planifikuar. Ju e dini se komplet Fidanishtja II është ndërtuar në mënyrë ilegale në kundërshtim me vendim të ministrive dhe e dini kush është investitor, por ajo është çështje krejt tjetër dhe ju e dini pse është bërë ajo!? Ju tash po merreni me një kat ose me tri dhoma apo me një shtëpi ose me 52 raste dhe prej 22 rasteve që unë i kam trashëguar janë bërë 52 raste, por do të marrim veprim të njëjtë. Atëherë do të marrim veprime të njëjta, nuk mundet dikush t' i bëjë 5 kulla në mënyrë ilegale e dikujt t' i prishet një shtëpi me dy dhoma. Nuk ka favorizime në këtë administratë dhe sado që e quani ju, nuk do të lejohet në asnjë mënyrë për të pasur favorizime. 26 milion euro janë investime këtë vit në Komunë të Gjilanit dhe investime publike pa aeroport. 26 milion euro investime publike, lexoni drejtë në buxhet në vijat ministore e që janë edhe te donatorët. Këto mjete do të harxhohen, por nuk janë të planifikuara për t' u harxhuar brenda një viti buxhetor, sepse janë planifikuar disa për një vjet, disa për dy vjet. Mirëpo këto mjete hyjnë në zbatim këtë vit dhe janë investimet më të mëdha që nga viti 1999 që kanë ardhur në Gjilan.

Unë mbështetem gjithnjë në buxhetin e Qeverisë i cili është buxheti kryesor. Nuk e përmenda punën e mirë të administratës, shërbimet e shpejta, jo vetëm online, por organizmi i të gjitha llojeve të shërbimeve.

Gjilani po rrëshqet drejt një programi të ri të qyteteve të mençura duke i realizuar këto shërbime.

Nuk desha ta përmendi servisimin e borxheve, por më detyruar dhe nëse dëshironi do të bëjmë krahasime me bileta me rominga, me shpronësime të parashikuara dhe të gjitha mjetet që janë, sepse qytetit të Gjilanit ia marrin 3 milion euro borxhet dhe me këto 3 milion euro Gjilani do të kishte bërë rrugë më shumë, infrastrukturë dhe shkolla, por ne duhet të lajmë borxhe pazare dhe muhabete të kaluarës. Këto borxhe nuk janë vetëm të një e dy viti, por prej vitit 2009. Ato nuk mund të mos i paguaj, sepse sipas detyrës ligjore nuk ka faj operatori. Mirëpo aty ku ka probleme ligjore si në Vërbicë të Zhegocit 700 mijë euro e cila nuk e ka asnjë procedurë ligjore dhe e cila është bërë me në komision dhe ka pasur tentativë për t' u mbyllur me komision pagesa. Nuk ka asnjë procedurë të prokurimit publik dhe është bërë vetëm komision. Ka edhe shumë çështje të tjera, por nuk dua të kaloj në monolog, sepse ne po përfaqësojmë subjekte politike këtu edhe angazhime politike. Unë jam i zgjedhur nga populli dhe mundohem për ta ruajtur paanësinë dhe nuk harxhoj mjete pa mbulesë dhe e kryej detyrën.

Në suficit 100 milion i dërgoj dhe pa mbulesë nuk i harxhojë. Nëse nuk mund mjetet të zotohen me kohë me ligj dhe procedura ato mjete le të shkojnë në buxhet të Kosovës, ato nuk shkojnë askund tjetër. Gjithçka që do të punohet, duhet të punohet me procedura ligjore dhe këto procedura janë bukur të rënda të gjata, por nuk ka rrugë tjetër që mund të realizohet.

Unë e di që jam në thumb të kritikës, por merreni më butë këtë punë, sepse nuk kemi asgjë personale. Unë më nuk lejoj të baltosem, unë dhe familja e ime për motive politike, për ambicie të sëmura politike dhe për konkurrenca jo reale. Ju duhet të fitoni, brenda partive të juaja dhe këtu nuk mund të fitoni ashtu dhe përfundimisht kjo është çështje e imja politike që po ia them dikujt, por është tepruar, sepse as unë nuk ia kam zënë udhën askujt.

Unë e kryej punën time i kam votat e qytetarëve dhe së paku PDK i ka pranuar zgjedhjet dhe kryetari i juaj ka konfirmuar se nuk ka problem me rezultate zgjedhore dhe ne mund të bashkëpunojmë në kuadër të rivaliteteve politike që i kemi. Tendenca me u sjell me dy fytyra dhe dy standarde nuk është e mirë dhe është këtu Izmiu dhe Bujari këta më njohin mua dhe është mirë së paku për ta pasur parasysh. Pjesën e fundit e personalizova dhe kam për ta mbajt si të tillë dhe mbani mend se raporti im është zyrtar dhe është çështje zyrtare dhe në çastin që e konsidero personale, atëherë do t' i zgjedhim problemet personalisht.

Riad Rashiti- më vjen shumë keqe që kryetari e mori nga zemra dhe u bë shumë nervoz dhe kjo nuk është shenj i mirë, sepse ka diçka në atë që e thamë ne. Kur është mirë dhe pastër, unë ndihem krenar për atë që e kam bërë. Mirëpo kryetari nuk mund të ndihet mirë, sepse nuk ka punuar asgjë. Ato që i thash qëndrojnë, por nuk ka nevojë për t' u shqetësuar, kritikën janë normale në politikë. Ju z. kryetar e thatë se kemi shpif, por thuaje se çka konsideron ti shpifje? Të gjitha kritikën që i dhash i dhash në emër të grupit dhe të gjitha janë në raporte zyrtare, sepse unë u bazova në raporte financiare, te prokurimi dhe në Agjension Kundër Korrupsionit dhe asnjë shpifje nuk e bëra. Këto gjëra janë të rënda, por unë nuk po i bëj asgjë kryetarit, ky po i bën vetes.

Te ndërtimet pa leje e përmende një kat, kryetar tash paska pak, por 86 vendime i ka marrë qeverisja e juaj për rrënim. Nuk është një kat, por në 10 kat një ndërtesë kolektive është ndërtuar te Tregu i Gjelbër dil dhe vizitoje,

10 kat janë aty komplet objekti. U përmendën dosje, por ne nuk bëjmë dosje, ne i denoncojmë rastet aty ku pretendojmë se ka shkelje dhe ty të intereson shumë, sepse edhe ju jeni njëri prej tyre që po hetoheni, nuk është shpifje kjo është deklarata që e ka dhënë Prokuroria Speciale, por mos u friko, sepse nëse nuk e ke shkel ligjin nuk ke pse të frikohesh. Edhe Qemajl Mustafës ia keni dërguar 70 dosje dhe hiq nuk po i frikohet, sepse nuk po ia ndien fare.

As ju kryetar mos u nervozo, por qytetarët po iu denoncojnë. Te prishja e planeve është shumë e vërtetë, se na i ke prish planet neve e të cilat plane kanë qenë shumë të mira. Ka qenë plani për t' u ndërtuar zona ekonomike, por ju ia keni vënë drurin këtij projekti, ka qenë e paraparë për t' i ndërtuar Kompleksi i shkollave të mesme, por ju qe dy vjet zhag po e mbani. Na e ke prish planin për transportin publik, është prish Planin për Tregun e Gjellbër. Ia keni prish planet qytetarëve të Komunës së Gjilanit dhe ia keni humbur perspektivën. E keni sjell kaosin, nuk mbulohen në asnjë mënyrë dështimet. Për Lumin Mirusha, nuk e dha asnjë përgjigje dhe kjo është turp i kësaj qeverisje! Ju vetëm punoni qetë, qetë, javash, javash dhe të gjitha punët kryhen, kurse ju vetëm punoni.

Lutfi Haziri- njeriu, kur të bëhet plak, jep edhe këshilla të mira dhe kjo është në rregull dhe asnjë problem nuk ka me sugjerime. Unë ia konfirmoj publikisht dhe zyrtarisht se Lutfi Haziri nuk është asnjë subjekt i hetimit deri më sot dhe asnjëherë nuk kam qenë për këto 16 vjet qeverisje. Kam qenë dëshmitar në disa raste iu kam përgjigj prokurorisë dhe e kam dhënë fjalën time. Nuk jam as nuk kam me qenë, përveç nëse ka denoncime nga subjekte të ndryshme. Se kush dhe kush është subjekt i hetimeve nuk është e imja për ta thënë dhe nuk i kemi dërguar në organe të aktakuzës jo 70, por as shtatë dhe 0.7 lëndë të ish kryetarit të Komunës në Prokurori nga kjo administratë dhe po e përsëris edhe njëherë se nëse nuk del kështu, fjala është publike dhe asnjë lëndë dhe asnjë.

Mirëpo a është shpifje kur thuhet se unë kam harxhuar roming, kur unë e paguaj romingun e ish kryetarit dhe nënkryetarit? A është shpifje, kur unë kam paguar bileta dhe të ish administratës dhe të atyre që janë autorizuar për të udhëtuar. A është shpifje për diçka që vazhdimisht e etiketon? Ai që është me peshë politike dhe njeri i rëndomtë nuk flet për pa e vërtetuar, a është shpifje për të thënë se Fondi i Solidaritetit po keqpërdoret? K a mundësi të pritet në buxhet, ku janë mjetë dhe sa mjete janë? Nuk dëshiroj dhe nuk mund të më bëni asnjëherë nervoz sa i përket punës sime, sepse për këto 16 vjet edhe 10 vjet para luftës, veprimtarie politike kam punuar në mënyrën time, në dijen time dhe kulturën time dhe asnjëherë nuk kam pasur problem dhe besoj se asnjëherë nuk do të kem problem. Nuk mund të thuhet se Komunës së Gjilanit ia ke humbur vizionin, kur ata me 60% kanë votuar për një vizion tjetër.

Qytetarët nuk kanë votuar për 13% të vizionit, ata kanë votuar për një vizion tjetër. Nuk mund tjetër kush në emër të qytetarëve askush tjetër dhe fatmirësisht, apo fatkeqësisht atë të drejtë e kam unë. Unë mendoj t' kryej detyrat sipas ligjit dhe nuk kam të bëj me asgjë tjetër. Ajo që është politike e zgjedhim këtu, por ato çështje që janë personale dhe që trajtohen personale, njerëzit i zgjedhin në mënyrë personale. Unë mendoj se është tepër për ta ngarkuar një Kuvend, një qytet me çështje personale. Unë e di që kam zënë rrugë, por kjo është politikë, sepse dikush vjen dhe dikush shkon. Prej momentin që e kam bërë betimin kam përmendur, probleme, defekte, borxhe etj.

Muhadin Haziri anëtar i Bordit në Eco-Higjienë, Gjykata Kushtetuese e ka kthyer në vendin e punës nga vendi i cili është suspenduar dhe asnjë shkelje konflikti nuk kam bërë ndaj tij. Organi më i lartë i gjykatës e ka kthyer në vendin e punës. Kush ka pasur të drejtë për ta dhënë tërë Tregun e Gjellbër për të ndërtuar banesa dhe lokale atje?

KK – ka pasur të drejtë për të dhënë, KK ka të drejtë për të dhënë, por unë nuk kam besuar në atë projekt dhe nuk kam besuar se edhe në Dardani duhet të bëhet Qendër Tregtare me banesa edhe te tregu Qendër Tregtare me banesa, po ashtu edhe te Stacioni i Autobusëve dhe gjithkund banesa –lokale dhe banesa lokale.

Unë besoj se më mirë në prona private investitorët të ndërtojnë banesa lokale, Komuna të rezervohet dhe të tërhiqet e që jam duke e zbatuar këtë dhe QKMF po ndërtohet në pronë publike, një vend që është vendi më i mirë në Gjilan.

Tregu po ndërtohet për nevojat e qytetarëve, sepse është Treg i Gjellbër. Banesa dhe lokale ka sektori privat, biznesi është privat ekonomia është private. Nuk më ka pëlqyer që subjekti i kadastrit është në hetime, sepse është bërë me dy ligje. Është bërë me ligj të PPP-së dhe me koncesione, toka e Komunës është dhënë për banesa.

Unë besoj se tokën e Komunës nuk duhet ta jep për banesa askush. Ka mjaft tokë, Gjilani është qytet, bashkohen pronarët dhe mund ta ndërtojnë Gjilanin në çdo mënyrë, vetëm a e lejon Plani urbanistik? Ky është dallimi që unë nuk e kam zbërthyer për ta kuptuar drejt. Nuk jap unë tokë të Komunës dhe së pari besoj se nuk kam të drejtë për të ndërtuar banesa edhe lokale, sepse Komuna bëhet më e pasur. Duhet të bëhet biznesi privat më i pasur, ata paguajnë taksa dhe ne pasurohem dhe kjo është logjika. Bajram Hasani është njëri prej investitorëve në Gjilan, unë nuk e kam penguar asnjëherë për të ndërtuar. Në përputhje me ligjin nëse është lejuar unë e kam mbështetur. Është fakt se jam tolerant prej natyrës dhe mua më kushton kjo. Mirëpo edhe këtë nuk do ta lejoj më dhe në të ardhmen nuk do të lejoj të ndërtohet asgjë për pa u bërë pagesa. Edhe një po e them se banesat kanë për t'iu dhënë njerëzve, ajo nuk mund të tjetërsohet, ajo pronë e Komunës është. Ato banesa mund të epen me qira për disa vite, kure nuk mund të shiten në asnjë mënyrë. Neve nuk na lejon ligji që të bëjmë biznes me prona.

Pas fjalës së kryetarit, kryesuesja i liroi anëtarët e Kuvendit në pushim për 10 minuta.

Riad Rashiti – unë nuk kam asgjë personale me kryetarin, nëse ky ka me mua le të urdhërojnë, unë as nuk jam frikuar dhe as nuk frikohem dhe asgjë personale nuk kam. Mirëpo unë nuk po mund të pajtohem me një fakt, sepse ky po i quan shpifje, por çfarë shpifje nga drejtori për Buxhet dhe Financa, sepse ai m' i ka dhënë dokumentet zyrtare. Nëse është në muajin 8 prill faturë romin 1 mijë euro, nëse është faturë e qeverisjes së kaluar 24 gusht e vitit 2015, 546 euro roming, nëse është faturë më 28 tetor 423 euro Zyra e Kryetarit, ka edhe shumë, por nuk po i numëroj.

Unë kërkoj përgjigje, a unë po shpifi, apo po i mohohon kryetari!?

Te biletat 1928 euro, Lutfi Haziri, Valnetina Bunjaku, më 6 shkurt. Mandej 4 mijë e 600, Naser Korça, Xhevat Latifi, 1mijë e 373 euro Veton Shaqiri udhëtim për Amerikë, 3 mijë e 680 euro tjera Lutfi Haziri, Prishtinë-Vjenë.

Në vijim të fjalës së tij z. Rashiti përmendi edhe shumë mëditje të tjera të kryetarit dhe të vartësve të tyre. Të gjitha këto janë shënime zyrtare dhe asgjë unë nuk po shpifi, por vetëm dëshiroj të them se unë nuk po shpifi, por po flas duke u bazuar në gjithçka në raporte zyrtare të juaja.

Lutfi Haziri- atëherë kjo është ajo që e tregon të vërtetën, parcialisht. Ne i kemi nxjerr shënimet për këto dy vjet për këto dy vjet për të gjitha borxhet me emër dhe mbiemër dhe do t' informojmë të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe do t' ia dërgojmë të gjitha medieve të shkruara në Kosovë. Të tëra ato që i përmendi z. Rashiti roming, janë të kryetarit dhe të ish nënkryetarit. Të gjitha do të vijnë me emra dhe me numër dhe të gjitha llojet e ushqimit dhe shpenzimet që i keni bërë. Deri më tash kemi pasur konsideratë sikur që e ka kultura qeverisëse gjithkund tjetër, por tash e tutje do të veprojmë ndryshe, por pas kërkesës së juaj do të fillojmë për t' i zbardhë të gjitha borxhet prej 3 milion euro, kujt ia kanë paguar dhe sa janë paguar? Do të shihet kujt iu kanë paguar, drekat, darkat dhe biletat zyrtare. E dyta, unë po iu lus se ky qytet nuk ka kulturë revanshiste dhe unë nuk hyj në atë histori dhe iu lus që mos t' i personalizoni problemet, sepse nuk ka fuqi në botë dhe unë prapa shpinës së dikujt nuk veproj asgjë. Unë kur ta personalizoj dërgoj njerëz dhe i shkojnë njerëzit te shpija burra dhe pleq që merren me këtë punë ose shteti, por prapa shpinës jo! E lus z. Rashiti që pas shpinës mos të veprojnë?

Selami Xhemajli- para se ta jap vlerësimin për Raportin e kryetarit për vitin 2015, unë i falënderoj të gjithë anëtarët e Kuvendit që me një koncenues morëm një vendim për çështjen e anëtarit të minoritetit serb i cili vepron në strukturat paralele. Ishte një shembull i mirë dhe shumica tregoi mirëkuptim për kërkesat e opozitës fillimisht dhe morëm një vendim çfarë duhej të ishte dhe konsideroj se edhe për këtë nuk duhet t' i merr meritat individit, sepse ishte vendim i tërë Kuvendit. Gjithashtu apeloj që gjuha e komunikimit në Kuvend të ruhet dhe të jetë sa më afër reales dhe mos të përzihemi në punët e organeve të ndjekjes duke përmendur emra dhe apeloj që mos ta shndërrojmë Kuvendin në arenë të akuzave. Sa i përket raportit të punës së kryetarit për sa i përket grupit të AAK-së, është një raport mirë i punuar teknikisht dhe profesionalisht me të dhëna të detajuara për çdo drejtori dhe njësi të ekzekutivit.

Ky raport karakterizohet me zvogëlim të shpenzimeve të luksit dhe mjete të shpenzuara janë destinuar për fusha të kulturës dhe sportit me çka është treguar një kulturë e mirë e menaxhimit të parash publike.

Gjithashtu karakterizohet me thithje të projekteve të shumta nga donatorët siç u përmend projekti për lagjen “Dardania” i cili projekt do të inaugurohet me 10 mars dhe është një e mirë që i dhurohet banorëve të asaj lagjeje. Sa i përket performancës së ekzekutivit gjegjësisht drejtorëve të AAK-së që përfaqësohet me partnerin qeverisës të LDK-së, unë e falënderoj edhe kryetarin për hapësirën që iu ka dhënë dy drejtorëve e të cilët kanë bërë mjaft në realizim të shumë projekteve dhe në të gjitha raportimet ka qenë edhe vlerësim i opozitës për punën e mirë të drejtorëve të AAK-së.

Këta drejtorë kanë realizuar shumë projekte të mira, si është shembulli me kiosqet nga Administrata e që është shembull jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Mua më gëzon edhe fakti i asfaltimit të rrugës Gjilan-Pograxhë e me çka po lidhet Komuna e Gjilanit me zonat kufitare të Kosovës Lindore.

Në emër të grupit të AAK-së, unë e përkrahi raportin.

Nevzad Isufi- Z. kryetar i Komunës raportet vjetore të punës duhet të jenë një çështje me rëndësi, për shkak se kemi përmbylljen e një viti të qeverisjeje komunal, prandaj mendoj si ju ashtu edhe të gjithë ne si anëtarë të Kuvendit do të duhej t’i kushtonim një vëmendje të veçantë, po sigurisht që edhe qytetarët do të jenë kureshtarë të dëgjojnë e të shohin se çfarë kanë bërë të zgjedhurit e tyre për një vit. Nga kjo që ne kemi të shkruar del se ajo që është raport juaji personal nuk kemi më shumë se 3 faqe tekst në mënyrë të përgjithësuar, ndërsa nga kjo më tepër se gjysma e kësaj përmbajtjeje i kushtohet planeve të së ardhmes, pra planeve strategjike dhe donatorëve të jashtëm të cilët priten të vijnë, ndonëse ne kaherë jemi në pritje të tyre por deri me tash ata nuk kanë ardhur. Pra fjala është për Qeverinë zvicerane nga e cila u pritka të bëjë rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit për të gjitha fshatrat. Pastaj përmendet Komisioni Evropian dhe tri projektet e saj si Biblioteke a Gjilanit, pastaj çerdhja në Dardani nga Qeveria Amerikane, çerdhja në shkollën “Abaz Ajeti” nga Qeveria Turke etj. Pra këto dhe projektet për hyrje-daljet në tri anët e qytetit, trajtimi i ujërave të zeza, autostradat etj., janë vetëm plane z. Kryetar, por nuk është dashur të jenë pjesë e raportit për punët e kryera për vitin 2015. Por si duket është bërë si traditë në këto raporte pune, sa herë që nuk kemi çka të themi për punët e kryera ose të pakryera, t’i kushtohemi së ardhmes, sepse përndryshe s’na mbetet shumë për të thënë.

Zyra ligjore

Në faqet 42-43 të planit të punës për periudhën e vitit 2015 të Kuvendit të Komunës, është paraqitur aktiviteti u Zyrës ligjore, ku ato janë gjithsejtë 1076 aktivitete, ndërsa në formë të një table ku kemi gjithsejtë 36 aktivitete, por pa ndonjë koment ose sqarim të tyre.

Mangësitë e raportit për zyrën ligjore janë:

1. Janë organizuar 10 debate –dëgjime publike por fare nuk jepen të dhëna se cilat kanë qenë çështjet e debatit. Nëse kanë qenë projektet e rregulloret përkatëse është dashur që në seancën e KPF dhe Kuvendit të komunës konformë udhëzimit administrative për transparencën në komuna, domosdo duhet të paraqitet raporti i cili përmban çështjen e debatit, numrin e të pranishmëve, vërejtjet, propozimet, të cilat janë të pranueshme dhe të papranueshme e pastaj koha e mbajtjes vendi etj.

Në të gjitha seancat KPF dhe Kuvendit në të cilat janë shqyrtuar projektet e rregulloret, fare nuk është paraqitur ndonjë raport për ecurinë e zhvillimit të debateve.

2. KPF dhe eventualisht ndonjë komitet tjetër përkatës fare nuk i ka paraqitur raport Kuvendit të Komunës me rekomandime për çështjet për të cilat është zhvilluar debat.

3. Komisioni statutar dhe për akte tjera normative i Kuvendit të Komunës, i themeluar në vitin 2014, me miratimin e ndryshimeve statutare ka ndërprerë punën, gjë që është e papranueshme. Ai është dashur të vazhdojë punën dhe t’i shqyrtojë projektet e të gjitha rregulloreve dhe akteve tjera normative, të cilat i shqyrton dhe miraton Kuvendi i Komunës.

4. Në tabelën e Zyrës ligjore fare nuk paraqiten të dhënat e kontratave civile në Gjykatën themelore në Gjilan. Sipas një raporti të Komunës të datës 22 janar 2014, detyrimet kontingjenteve kanë qenë 290,3510 €. Numri i lëndëve gjyqësore në procedurën kontestimore-kërkesat në të holla, në të cilat Komuna e Gjilanit paraqitet në cilësinë e të paditurës kanë qenë 126. Ashtu që këto konteste fare nuk trajtohen nga kjo zyrë.

5. Udhëheqësi i Zyrës Ligjore rregullisht është i pranishëm në seancat e KPF-ës dhe të Kuvendit të Komunës, në punime të cilave janë të pranishme shkeljet drastike të rregullave ligjore dhe të atyre nënligjore, duk e nisur nga mos respektimi i vazhdueshëm i afatit për dërgimin e njoftimeve për seancat e KPF dhe të Kuvendit. Është e pranishme mungesa e materialeve sipas rendit të ditës. Shqyrtimi i projekt vendimeve për emërimin e përbërjeve të komiteteve dhe të komisioneve të Kuvendit të Komunës, në KPF pa emrat e anëtarëve të këtyre trupave ndihmëse të Kuvendit, është një dukuri negative e pranishme që nga seancat e para të Kuvendit dhe vetëm kohëve të fundit ka një përpjekje për ndryshim. Madje janë të pranishme shumë e shumë shkelje tjera të rregullave ligjore dhe nënligjore. Kjo Zyrë është kompetente dhe është ajo e para, e cila duhet domosdo të ndërhyjë për të penguar mos respektimin e parimit të sundimit të ligjit.

Department i Prokurimit

Aktiviteti i këtij departamenti trajtohet në fq. 40-41 të raportit të punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar – dhjetor 2015.

Në tabelën e aktiviteteve të prokurimit për periudhën raportuese janë paraqitur 185 aktivitete, 83 kontrata të nënshkruara, por nuk është paraqitur e dhëna shumë e rëndësishme shuma e përgjithshme e mjeteve të investuara dhe të shpenzuara.

Mangësitë në punën e prokurimit janë:

1. Si në këtë vit edhe në vitin e kaluar në vendimin e buxhetit për vitin 2015, fare nuk kanë qenë të përfshira këto aktivitete e as vlera e tyre, as parametrat themelor e as lokacioni, me siguri për këto projekte vendosin drejtorët dhe këto ia dërgojnë për procedure të mëtejshme Departamentit të prokurimit. Në këtë mënyrë është anashkaluar kompetenca e Kuvendit të Komunës që me vendim të përfshihen të gjitha projektet.
2. Edhe pse drejtori i tashëm i Drejtorisë së Financave pat premtuar që këtë vit projektet e vitit të ardhshëm do të përfshihen me vendimin për buxhetin e viti 2016, por praktika e vjetër është përsëritur.
3. Që nga viti 2008, që kur ka hyrë në fuqi LVL, duke përfshirë edhe vitin 2015, asnjëherë nuk është respektuar neni 52.2 I LVL, i cili në mënyrë të saktë përcakton se KPF është përgjegjëse për shqyrtimin e planit vjetor të prokurimit, e pastaj atë e miraton Kuvendi i Komunës.
4. Pra në rastet e këtilla është anashkaluar KPF-ja dhe Kuvendi. Një veprim i tillë i jep mundësi drejtorit dhe Departamentit të prokurimit dhe Kryetarit të Komunës për manipulime.
5. Në aktivitetet e Prokurimit nuk është përfshirë aktiviteti-projekti “Rrugët e rendit të tretë”, ku në 26 fshatra janë paraparë rregullime të rrugëve të rendit të tretë në gjatësi prej 70 km. Ne konsiderojmë se menjëherë pas miratimit të buxhetit, patjetër është dashur që Departamenti për prokurim ta hartoj dhe ta dërgoj në shqyrtim Planin vjetor të Prokurimit për vitin 2016, KPF-së pastaj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
6. Pra plan vjetor i Prokurimit deri më tash nuk është shqyrtuar në KPF dhe as është miratuar në Kuvend.

Njësia e personelit

Në fq. 31 në një gjysmë të saj të raportit të Kryetarit të komunës së Gjilanit për vitin 2015, janë paraqitur 126 aktivitete të kësaj zyre, por vetëm në mënyrë të përgjithësuar dhe numerikisht por pa ndonjë koment. Në krahasim me numrin e kontratave në vepër të paraqitura në raportin e Kryetarit të Komunës në raport me periudhën janar-shtator, në këtë raport vjetor ky numri kontratave është shtuar edhe për 68 kontrata, kështu që numri i përgjithshëm i kontratave në vepër arrin shifrën 313. Si për aktivitet tjera edhe për këtë nuk kemi asnjë koment.

Botërisht dihet se me anë të këtyre kontratave me të madhe Kryetari i komunës dhe bashkëpunëtorët e tij e bëjnë punësimin e simpatizantëve dhe të fafesisit të LDK-ës në shërbimin civil komunal, gjë që paraqet shkelje flagrante të rregulloreve të Ligjit për shërbyesit civil. Ne vazhdimisht ju kemi dëgjuar si keni

kritikuar udhëheqjen e kaluar, por Ju e keni përshkallëzuar edhe më shumë këtë dukuri dhe ku ta dish sa do të jenë këto shifra deri në fund të mandatit tuaj qeverisës.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Infratstrukturë dhe Banim

Në fq. 21-23 të raportit të Kryetarit të Komunës për vitin 2015, është trajtuar aktiviteti i Drejtorisë komunale për shërbime publike.

Në renditjen e aktiviteteve të kësaj drejtorie paraqitet sinjalizimi vertikal e horizontal, numërizimi i objekteve nuk përmenden fare, lokacionet, rrugët dhe lagjet e as jepen shumat e shpenzuara të mjeteve financiare. Po ashtu edhe te projekti i sanimit dhe ndriçimit publik në fsh. e Komunës së Gjilanit nuk paraqiten vendet-fshatrat dhe shuma e mjeteve të shpenzuara.

Projekti-rrugët e rendit të tretë 72 km në fshatra dhe 82 km rrugë të renovuara dhe të shtruara fare nuk jepen fshatrat ku janë ndërtuar këto rrugë e as kostoja financiare e tyre. Në Fq. 72 të raportit paraqiten tabela 6 projektet tjera, asfaltimi i rrugës në lagjen Zabeli i Sahit Agës. Për këtë projekt paraqitet çmimi financiar, por nuk jepet gjatësia e saj. Po ashtu edhe në vazhdimin e kësaj tablele paraqiten edhe 12 projekte të rrugëve, prej të cilave 5 projekte në realizim e sipër dhe 7 projekte të realizuara. Për secilin projekt veç e veç paraqitet edhe çmimi financiar, por jo edhe gjatësia e tyre.

Në tabelën 7, Projektet e kanalizimeve paraqiten 4 projekt edhe kostoja e tyre financiare, por nuk paraqiten gjatësia e rrjetit veç e veç, për secilin projekt. Në këtë pjesë të raportit përmenden edhe këto aktivitete; caktimi i lokacionit të ri të varrezave të qytetit, ndërtimi i kolektorëve të ujërave fekale në qytet fshatra, zbatimi i planit të mobilitetit në trafik. Caktimi i vendit dhe rregullimi i tregut të kafshëve. Caktimi i vendit dhe rregullimi i vendit të druve dhe rërës. Ndërtimi i autoparkut për vendosjen e makinave të aksidentuara dhe të tjera që tërhiqen të parkingut të gabuar. Këto aktivitete vetëm në mënyrë të përgjithshme janë paraqitur, pa ndonjë të dhënë konkrete për t'i kuptuar anëtarët e eKuvendit dhe opinion më i gjerë gjë që është në kundërshtim me parimin e transparencës. Natyrisht të gjitha këto që përmenda së fundi pra mbesin edhe më tutje për periudhën e ardhshme, prandaj nuk është dashur të përmenden sepse janë projekte sfiduese për Drejtorinë dhe nuk do të duhej përfshirë në këtë raport sepse janë plane të së ardhmes. Pra projekte të pa filluara ende.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë

Aktiviteti i kësaj Drejtorie është përfshirë vetëm në dy fq.24-25 të Raportit të Kryetarit të Komunës, në të cilin paraqiten aktivitetet e saj në shtimin e sipërfaqeve tokësore të të mbjellurave me kulturën e grurit dhe misrit, si dhe në shtimin e numrit të krerëve të lopëve qumështore dhe shoqërive të bletëve. Bujqit e komunës së Gjilanit kanë përfituar subvencione nga skema e MBZHR dhe skema e grandeve të saj, me ç'rast janë realizuar disa projekte nga Komisioni Evropian si dhe nga organizatat qeveritare të Turqisë. Vlejnë të theksohet se në vitin raportues ka filluar realizimi e implementimi i projektit të rrugëve fushore dhe në këtë projekt është investuar shuma prej 81.154.00 eurosh.

Ndonëse në këtë raport të kësaj drejtorie nuk kemi të paraqitura të dhëna në mënyrë tabelare, për mendimin tonë kemi më shumë qartësi, sepse janë dhënë edhe shifrat e shpenzuara për aktivitete të ndryshme, gjë që e bënë këtë raport më transparent.

Zyra për Integritet Evropian

Në fq. 39 të Raportit të Kryetarit të Komunës për vitin 2015 kemi 8 rresht, ku është pasqyruar aktiviteti nëntëmujor i Zyrës për Integritet evropian. Në mungesë të të dhënave relevante nuk mund të vlerësohet performanca e kësaj zyre në periudhën raportuese. Ka munguar si në të kaluarën edhe gjatë vitit 2015, aktiviteti i kësaj zyre në paraqitjen dhe dërgimin e raporteve për çështjet nga kompetencat e kësaj njësie organeve të administratës komunale për shqyrtim në KPF dhe Kuvend.

Bazuara në këto pak fjali të shkruara është vështirë të imagjinohet se çfarë punë paska kryer kjo zyrë për periudhën një vjeçare.

Njësa për të Drejtat e Njeriut

Në fq. 32 në gjysmë faqe të raportit të punës të Kryetarit të Komunës për periudhën janar –dhjetor 2015 është trajtuar puna e Njesisë për të Drejtat e Njeriut.

Detyrë dhe kompetencë e kësaj Njësie është të monitoroj zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut, në fushat për të drejtat e fëmijëve, barazi gjinore, kundër diskriminimit, kundër trafikimit me qenie njerëzore, të drejtat e komuniteteve, personave me aftësi të veçanta, përdorimin e gjuhëve etj.

Ndër të tjera monitoron seancat e kuvendit të komunës dhe të komiteteve.

Organizon debate e takime me organizatat vendore e ndërkombëtare të cilat merren me të drejtat e njeriut dhe për këto nuk kemi ndonjë të dhënë.

Për mendimin tonë edhe kjo njësi nuk është dashur të mjaftohet vetëm me promovimin e të drejtave të kategorive të ndryshme të shoqërisë, por të ketë hulumtuar e shënuar edhe rastet, shifrat e kategoritë, kur dhe sa janë cenuar këto të drejta ose kemi ngritje apo rënie në zbatimin e të drejtave të njeriut.

Sikurse vitin e kaluar edhe këtë vit nuk kemi as edhe një fjalë për Teatrin e qytetit, sikurse ai të mos ishte pjesë e Njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Mbase për shkakun se janë shumë po mbahet nga subvencionet apo ai nuk është pjesë e kësaj njësie.

Nevzad Rushiti- mendimi im është se disa kuvendarë nuk e paskan lexuar fare raportin, apo nuk kanë dashur për ta kuptuar si raport. Në këtë raport janë të dhënat për punët që janë krye gjatë vitit 2015 dhe punët të cilat janë në vazhdim e sipër si dhe projektet që janë bërë për vitin 2016. Më duket se është injorim për të thënë se kryetari nuk i ka zhblllokuar aktivitetet që kanë mbetur në gjysmë. Edhe bibliotekën, nëse edhe objektin e MPB-së do ta kryejë kryetari edhe projektin e Varrezave të Dëshmorëve, projektin në “Dardani” dhe shumë projekte të tjera të cilat kanë mbetur që 6 vite. Nëse kemi pasur dëshirë ne si qytetarë të Gjilanit për ta parë Bibliotekën e Gjilanit duke u degraduar, atëherë sipas opozitës kryetari paska bërë gabim, por unë e vlerësoj si një angazhim të tij personal pa marrë parasysh se e a është bërë me ndërkombëtarët, apo me Qeverinë, por kryesorja është mirë që janë zgjidhur këto probleme. Duhet pranuar se kemi për të filluar me tri dalje të qytetit e për të cilat është nevojë të madhe e Gjilani dhe duhet t’i përkrahim projektet e mëdha siç është ajo për Kamenicë dhe Bujanoc dhe dy rrugë të tjera.

Sa i përket ndërtimeve pa leje po e jap një mendim timin e që e kam thënë gjithmonë dhe kryetari i Komunës e ka formuar një sektorë në kuadër të asaj drejtorie e që do të thotë se ky sektor brenda 6 muajve i ka sjell të ardhura buxhetit të Komunës afër 700 mijë euro e të cilat të hyra janë nga ndërtimet e larta. Mirëpo duhet pranuar se banorët e Gjilanit si në qytet dhe fshatra e shohin punën që e kemi bërë gjatë vitit 2015.

Në Dheun e Bardhë në Miresh, Zhegër, në Kodrën e Dëshmorëve e shumë fshatra tjera kemi shumë kilometra në të cilat është bërë asfaltimi dhe infrastruktura nëntokësore. Nuk mund t’i mohojmë këto punë, sepse qytetarët i shohin dhe i prekin çdo ditë këto të arritura. Kryetari e tha se pronën publike, duhet ta mbrojmë dhe LDK e ka pasur si parim për ta mbrojmë pronën publike, sepse kjo pronë i jep frymë qytetit tonë. Mirëpo përkundrazi prona publike është shkatërruar në Komunë të Gjilanit, por edhe një le të dihet se Komuna e Gjilanit punon në 6-7 objekte, por edhe këtë projekt do ta përfundojë kryetari i Komunës dhe gjatë këtij mandati do të jemi në një objekt. Do ta kemi një objekt të madh në Gjilan dhe një Shtëpi të Bardhë ku do të punojë administrata komunale.

Ne jemi këtu dhe kemi qenë PDK dhe LDK kur është dhënë kadastrin, por ne nuk jemi pajtuar me mënyrën se si është dhënë. Tash është problem edhe për kryetarin edhe për Kuvendin dhe ekzekutivin se si ta trajtojmë atë ndërtim? Ky rast nuk ka asnjë arsyetim dhe nëse dikush thotë se është bërë mirë le ta komentojë? Nuk mund të shiten as lokalet as banesat? Gjithashtu edhe parkun e biznesit nuk e kemi përkrahur z. i nderuar anëtar i Kuvendit “pa emër”, sepse kemi thënë se Komuna e Gjilanit është e madhe për regjionin dhe nuk kemi mundësi ne të bëjmë biznes në Artanë ose Llabjanë. Tash po e përmendi edhe autostradën dhe kurrë ky kolegu i im nuk ka thënë se nuk ka para Qeveria për pjesën perëndimore të Kosovës, por do ta përkrahim, sepse do të ketë para., sepse është obligimi shtetit. Sa i përket Lumit Mirusha, z. Qemal Mustafa 2+4 Qemajl Mustafa e ka pasur pushtetin, kurse ne kemi qenë në opozitë, prandaj ta analizojmë se çka ka punuar? Shumë pak ka punuar në pjesën jugore, në pjesën perëndimore prapë ky pushtet me mundësitë që i ka pasur e ka rregulluar kanalizimin deri në rrugën qarkore.

Mirëpo ne jemi tash në fazën që do të zbatohet komplet projekti dhe besoj se do të kryhet.

Edhe në fund më duhet ta them se kryetarit Lutfi Haziri besimi iu ka dhënë nga qytetarët dhe jo nga ne që jemi këtu dhe besoj se edhe një mandat e ka të siguruar nëse kërkon për të kandiduar.

Isa Agushi- unë nuk e pata ndërmend për ta marrë fjalën, por nuk mund gënjeshtro t' i pranoj dhe t' i përpijë. Një raport shumë i mirë i detajuar të cilin e kam lexuar shumë, kurse dikush nuk e a lexuar fare, por vetëm ia fut kot, tregon pallavra dhe flet të pavërteta. I tërë Gjilani e dinë se çfarë gjendje është në këtë Kompani dhe çfarë probleme ka higjiena. Aksionarët ne i kemi zgjedh dhe votuar këtu. Kolegu më parë e përmendi se ka dosje këtu, ka aty, por është e ditur se për kë është fjala (është për Muhadin Hazirin). Kryetari e përmendi dhe e tha se Muhadini e ka fituar edhe Gjykatën Kushtetuese, nëse i beson kësaj gjykate nëse jo, atëherë është problem tjetër.

Sa i përket Lumit Mirusha 6 vjet mandat i keni pasur, kryeministrin e keni pasur të tuajin, prandaj pse nuk e përfunduat ju? Keni pasur mjete për tjera gjëra, kurse Mirushën nuk e keni kryer, kurse ne po ia shlyejmë borxhet dhe plus kërkon për ta përfunduar këtë projekt. Më duket se ka filluar pak herët fushata elektorale, por vitin e ardhshëm fillojmë me fushatë dhe jo këtë vit. Mirëpo në Kuvend nuk bëhet fushata, por me qytetarë duhet të dalim të flasim dhe me qytetarë duhet të merret mandati. Kryetari e ka fituar mandatin, do të shohim, përsëri në garë do të hyjmë dhe do ta shohim? Ju tash jeni në opozitë dhe normal puna e juaj është për të kritikuar dhe punë tjetër nuk keni. Ne jemi për të punuar, por ne punojmë, kurse ju po shihni vetëm zi dhe ndoshta symbyllur po ecni nëpër Komunë. I kemi edhe dy vite, pasatja fillon gara dhe rezultatin e shohim në fund, por besoj se fitoren do ta kemi, sepse punët janë duke shkuar mirë. 26 milion euro investime i kemi bërë, kurse i kemi edhe 2 vite mandat. Po iu garantoj se humbjen e keni të garantuar dhe për mandatin tjetër, sepse këto para që po vijnë fal punës së kryetarit, mandatin e kemi të garantuar. Kryetari e tha se Gjilani kurrë në historinë e vetë nuk i ka pasur 26 milion euro investime, prandaj është bërë një punë shumë e mirë dhe dikush ka merita këtu. Unë qarkulloj çdo ditë edhe në fshatra dhe qytet dhe në çdo vend vërehen investime solide, aq sa është mundësia e jonë. Në fund ju i nderuari këshilltar, mos shpif për Muhadin Hazirin, sepse Muhadini i ka fituar të gjitha kontestet gjyqësore.

Bujar Nevzadi- nuk e kam pasur qëllimin që ta marrë fjalën, por më nxitën disa diskutues, por sot së pari kryetari më ka befasuar, sepse unë e njoh qysh para 25 viteve dhe të gjithëve po iu tregoj se e kam mik të shtëpisë dhe sa i përket miqësisë, miq më të mirë nuk kemi. Mirëpo unë po e them publikisht se unë Bujar Nevzadi nuk kemi asgjë personale me Lutfi Hazirin, por kemi me kryetarin e Komunës dhe me këto që po i themi për kryetarin e Komunës i cili i ka fituar 26 mijë vota e që po i përmend së paku 100 herë.

Ne nuk ia kemi mohuar ato vota, ia kemi pranuar, ia kemi uruar dhe absolut nuk kemi asgjë private dhe asnjëherë nuk kemi dal në protesta dhe asnjëherë nuk kemi kërkuar dorëheqje. Të gjitha këto që i kemi thënë për të mirën e kryetarit të Komunës, sepse kemi menduar që janë të meta. Kryetari u nervozua shumë, por nëse është puna pastër nuk ka nevojë të nervozohet. Kush flet pa argumente, ai më së tepërmi e nervozon veten.

Unë do të flas diçka edhe për raportin dhe po flas me emër, se Z. Avdyli kur e përmendi një shkollë dhe diçka për PDK-në, prandaj unë i kam thënë dhe po i them që është shkatërruesi më i madh i Komunës së Gjilanit! Do të iu them juve të nderuar këshilltarë, se sa herë të flas ky LDK i ka 1 mijë vota më pak dhe është më mirë që ky mos të flas fare, sepse vetëm i turbullon gjërat.

Sa i përket raportit të kryetarit, aty ka vetëm lëvdata dhe punë të mira dhe nuk e tha se cila drejtori ka pasur vërejtje dhe kemi pasur edhe pengesa gjatë rrugëtimit dhe kemi pasur edhe sugjerime, por kryetari asnjë të metë nuk e pat. Nuk u përmenden ndërtimet pa leje, shefi i grupit e dini se është i vetmi që e ka ndërtuar objektin 3 kat më tepër se sa ka pasur leje dhe ajo shihet qartë. Vetëm shefi i grupit të LDK-së ka pasur të drejtë ta ngris objektin 3 kat më tepër se të tjerët. Nuk u përmenden problemet në Arsim, sepse në Zabel është pranuar kandidatja e 14, nuk u përmenden 2 javë në “Th, Mitoko”, ka pasur problem, në Gjimnaz ende nuk mbahet mësim, nuk u tha se ka pasur konkurs për infermiere për 13 kandidate, kurse janë pranuar 43 dhe nuk dihet se me çfarë baze ligjore janë pranuar ato? Në aspektin human u përmend ndërtimi i shtëpive të cilat ne i përkrahim dhe i përshëndesim, por cilat është pengesa që nuk është bërë një raport me shkrim? Duhet të thuhet sa mjete janë grumbulluar, sa shtëpi janë ndërtuar dhe të gjitha të dhënat e tjera etj? U përmend edhe Shtëpia e Kulturës në Përlepnice, por e lus kryetarin që mos ta përmendin, sepse është bërë viti i tretë, por edhe unë nuk jam i pafaj që nuk është ndërtuar ajo shtëpi dhe ajo vetëm po shkatërrohet. Kryetari e përmendi 20 euro telefonin, por unë jam këshilltar, arsimtar dhe nga 40 euro paguaj telefon. Dhe nuk e di se sa pak po harxhuaka kryetari?

Lutfi Haziri- faleminderit, z. Isufi faleminderit për vërejtjet dhe sugjerimet e tua, por unë i kam ikur punës ime personale dhe jam munduar për ta shpërndarë raportin në sektor dhe në njësi ashtu siç punoj. Ndoshta është rekomandim që unë duhet ta marrë parasysh për ta ndërruar formatin e raportimit duke i nënvizuar edhe ato kërkesa që kanë të bëjnë me programet projektet dhe koston dhe nevojat e tjera që duhet t' i ketë raporti.

Duhet pasur një qasje të drejtë të raportimit e të jetë i lexueshëm i pranueshëm i drejtë dhe si të tillë për ta pasur. Natyrisht unë i pranoj rekomandimet, i pranoj vërejtjet, sepse gjithmonë ka vend për këto gjëra.

Komuna e jonë i ka specifikat e vet dhe i ka vështirësitë e veta dhe i ka telashet e veta.

Mirëpo sa herë po e përmendim se cili është guri në qafë i kësaj Komune, atëherë po dalim jashtë politikës.

Çdo zot i shtëpisë që mendon të punojë diçka, por i ka 10 mijë euro borxh, është e pamundur të punojë për pa i paguar borxhet. Borxhet mund të programohen, por borxhi ditë të bardhë nuk pret dhe për këtë arsyeje mua më është deshtë që të largohem nga ky obligim. Pavarësisht se kush është kandidatë në zgjedhjet e ardhshme, së paku duhet ta merr komunën me borxhe sa më të vogla. Ligji na e ka dhënë një përparësi dhe 7 milion euro iu janë fal qytetarëve në Gjilan, kurse kanë mbet për t' u grumbulluar 2.1 milion euro.

Në vijim të fjalës së tij z. Kryetari i përmendi projektet në të cilat duhet të fillohet puna e të cilat kanë mbetur për pa u përfunduar.

Shukrie Rapuca- faleminderit zonja kryesuese edhe pse me vonesë po më epet fjala, ju si femër duhet pasur kujdes për koleget femra. Sot folëm shumë për këtë raport, por e di që u fol gjatë dhe u tha se shumëkush nuk e ka lexuar raportin dhe nuk din se çka të flasim. Për të treguar se e kam lexuar po i përmendi disa pika kryesore.

Së pari kryetari e tha për një koleg se ke bërë monolog dhe nuk ka bërë debat. Mirëpo kryetari nuk ka ditur ta hartojë raportin me kohë të caktuar dhe nuk janë përfshirë dy tema p.sh. raporti i Kryetari të Komunës janar – dhjetor 2015. Ky raport fillon me titullin: Përmbledhje e zhvillimeve kryesore gjatë vitit 2015, koha dihet dhe kjo është koha e kryer, por që nga fillimi dhe deri te faqja nr. 16 flitet për planet apo për punët që mund të kryhen gjatë vitit 2016 dhe shumë pak apo aspak nuk iu ka kushtuar punës dhe angazhimeve të vitit 2015.

Shikuar nga përmbajtja ky dokument nuk është raport i punës për vitin 2015, por plan i punës për vitin 2016 i cili edhe si plan është mjaft ambicioz, por vështirë i realizueshëm.

Po citoj për të treguar se e kemi lexuar raportin: “investitorët më të mëdhenj të Komunës sonë, Qeveria Zvicerane, KE, Qeveria Amerikane dhe ajo Turke e shumë partnerë dhe investitorë kanë filluar me këto projekte dhe janë ende në realizim”. Këto projekte do të thotë i takojnë kohës së ardhme dhe janë ende të parealizuara, prandaj kjo është në kundërshtim me titullin e raportit të kryetarit. Mandej thuhet po ashtu se Qeveria Turke do të ndërtojë edhe një çerdhe të shkollës “Abaz Ajeti”. Unë disa herë kam pyetur z. kryetarin se çka ka ndodhur me sallën e edukatës fizike së cilës komplet iu ka ndryshuar plani dhe çka ka ndodhur me disa anekse përmes së cilës është bërë një konglomeratë betoni dhe argjiri dhe asgjë tjetër. Në shkollën tonë me këtë punë vetëm është bërë një shëmti dhe asgjë më tepër. Punët e papërfunduara e që Qeveria e kaluar ka premtuar se do t' i përfundojnë i kemi 17 programe, por ende nuk kanë filluar këto projekte, ne këto projekte i kemi filluar vetë dhe nuk janë projekte të juaja .pastaj thuhet se ka ardhur koha të punojmë në disa rrugë si është ajo në fshatin Kosaçë, Malishevë të Epërme edhe këtu kemi të bëjmë me folje të kohës së ardhme do të,...do të...

Po ashtu për vitin e ardhshëm thuhet do ta kemi partnerin më të madh Qeverinë e Austrisë, do ta kemi me të cilën kemi marrëveshje për të investuar në Gjilan në vlerë prej 12 milion euro, për projektet që do t' i hartojmë dhe prapë është do të. Në fund mund të them se të gjitha këto projekte e kanë shprehjen do të realizohen dhe do të përfundojnë. Për mos ta zgjatur më shumë raportin i takon punëve në kohën e ardhme dhe nuk i takon punëve të kryera.

Fehmi Sylejmani- aktiviteti i DKA në raportin vjetor të punës së kryetarit të komunës për vitin 2015 është përfshirë në tri faqe, gjë që është një hapësirë shumë e vogël dhe e pamjaftueshme për të dhënë një vlerësim real në këtë fushë të administratës, e cila në periudhën raportuese ka pasur rezultate pozitive, por edhe defekte dhe dështime të dukshme. Në faqe 12 të raportit paraqiten objektet dhe numri i nxënësve, pa kurrfarë komenti. Po ashtu në tabelën e 5-të paraqiten të dhënat për stafin e DKA-së dhe institucioneve arsimore, po ashtu pa ndonjë koment. Si në konstatimet e mësipërme, po ashtu edhe në pjesën e raportit ku flitet për sektorin e arsimit dhe personelit, numërohen vetëm aktivitete pa ndonjë koment pozitiv apo

negativ. Derisa shkolla e arteve as që ka filluar, përveç që është grumbulluar paska dheu aty, sa për të thënë se është nisur.

Gjithashtu në këtë raport nuk figuron se a janë arrit objektivat dhe qëllimet e parapara si kundër që mungojnë statistikën, përqindjet, fotografitë dhe tabelat e nevojshme për këtë raport, ndonëse shumë më i mirë është pasqyruar një raport i DKA në KA. Kjo formë e raportit të punës nuk është në nivelin e dëshiruar, sepse asnjë punë nuk përcillet pa vështirësi, lëshime, defekte, pengesa dhe sfida të ndryshme.

Mangësitë që e kanë përcjellë DKA gjatë viti 2015

1. Kemi pasur mos shpallja e vendeve të lira të punës, gjë që u vërtetua edhe nga Inspektorati Rajonal i Arsimit.
2. Janë bërë transferime të drejtorëve nga një shkollë në tjetrën pa kurrfarë procedurash, transferime të mësimdhënësve, madje edhe prej komunave tjera.
3. Zgjedhja e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve sipas ligjit për shërbyes civil. U krijuar një lloj konfuzioni, konflikt në mes dy ministrive, asaj të Administratës dhe Ministrisë së Arsimit. Sërish patë pakënaqësi dhe skandale për ekskursionin e maturantëve.
4. Regjistrimi i nxënësve në klasat e para me formulën e zarfit, mjerisht nuk është respektuar, ka pasur shkelje të konsideruara dhe asnjë udhëheqës i shkollës apo mësimdhënës nuk është ndëshkuar.
5. Regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta, disa shkolla kanë numër të tejkaluar, duke shkelur çdo normë ligjore, ndërkohë që janë formuar dy paralele në Mjekësi dhe dy në shkollën e mesme të arteve, në mënyrë jashtëligjore. Më çfarë të drejte dhe me çfarë baze ligjore z. kryetar, ju keni hap këto paralele?!. Ndërkaq, shkolla e mesme e Agrobiznesit në vazhdimësi po përballlet me telashe rreth numrit të duhur të nxënësve.
6. Komisioni zyrtar për pranimin e drejtorëve dhe zv. drejtorëve, i kontestuar, meqë njëri nga këta panelist ishte shkarkuar nga pozita e udhëheqësit të shkollës për shkak të parregullsive dhe keqpërdorimit të detyrës, e tjetri pa përvojë dhe krejt vonë i certifikuar për udhëheqje dhe menaxhim.
7. Dy zyrtarë në DKA, tash dy vjet e gjysmë punojnë pa konkurs dhe janë militantë të LDK.

Drejtoria e Administratës së përgjithshme

Në faqet 7. 8 dhe 9 të raportit të kryetarit të komunës për vitin 2015, trajtohet aktiviteti i Drejtorisë komunale të administratës së përgjithshme.

Paraqiten rezultate siç janë:

Implementimi i projektit Telework” si projekt i parë në Kosovë dhe Rajon, aplikimi i regjistrimit online për procedurat administrative e tjera, të cilat kanë ndihmuar në përshpejtimin e procedurave për pajisjen e qytetarëve me ekstrakte përkatëse të certifikatave të gjendjes civile.

Në tabelën e të dhënave të shërbimeve të ofruara nga SHCK në mënyrë të ndarë për secilën drejtori janë paraqitur ndaras lëndët me procedurë administrative. Vlen të konstatohet se Drejtoria për bujqësi është dalluar për mos efikasitet dhe neglizhencë në zgjidhjen e lëndëve. Më konkretisht kjo drejtori në periudhën raportuese I ka pranuar gjithsej 2365, prej tyre I ka zgjidhur 1246 apo 50 %. Për këtë dështim fare nuk jepet ndonjë sqarim.

Mangësitë në aktivitetin e Drejtorisë komunale për administratë të përgjithshme në periudhën raportuese janë:

1. Kjo drejtori me vite të tëra, e as në vitin raportues nuk ka plan vjetor të punës, ashtu që punën e zhvillon në mënyrë stihike.
2. Në raport fare nuk paraqitet aktiviteti i zyrave të gjendjes civile në fshatra dhe në spitalin rajonal.
3. Zyrtarët e gjendjes civile në fshatra, që nga pas lufta fare nuk janë të përfshira në rregulloren për kompetencat e drejtorive komunale në kuadër të drejtorisë për administratë të përgjithshme.
4. Sikur vitin e kaluar, po ashtu edhe këtë vit, nga kjo drejtori, as në KPF e as në ndonjë seancë të KK nuk është trajtuar asnjë çështje.
5. Kjo drejtori as në vitin e kaluar e as këtë vit, nuk ka dërguar asnjë çështje për t’u përfshirë në planin vjetor të punës së kuvendit komunal.
6. Kjo drejtori nuk e posedon rregulloren për shfrytëzimin e automjeteve të komunës.

7. Është dashur që së paku një herë në vit, kjo drejtori t'i paraqet kuvendit komunal raport për realizimin të drejtave të qytetarëve dhe personave juridik në shërbimin civil komunal.

Zyra komunale për komunitete dhe kthim

Kjo zyre aktivitetin e saj e zhvillon kryesisht në çështjen e riatdhesimit e të kthyerve nga shtete perëndimore.

Në periudhën janar- shtator 2015 janë riatdhesuar gjithsej 134 familje me 298 anëtar. Vlen një vlerësim i përbashkët për të gjitha zyrat komunale se ato nuk janë në nivel të detyrës.

Zyra për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

Kjo zyre është një njësi e re organizative në kuadër të administratës komunale, e cila veprimtarinë e saj e zhvillon që nga ky vit, përkatësisht 2015, detyra e së cilës është që të ndërmerr aktivitete të bashkëpunimit me organet komunale dhe me ato në rrafshin e republikës për të zgjidhur çështjet e fituara të shtetësisë së Republikës së Kosovës për qytetarët shqiptarë të Luginës së Preshevës, të cilët jetojnë në komunën e Gjilanit.

Zyra për Informim

Në faqen 43 të raportit të punës së kryetarit të komunës për periudhën 12 mujore, janë të përshkruara disa fjalë për punën e zyrës për informim.

Në këtë pjesë të raportit qëndron konstatimi se kjo zyre është një segment shumë i rëndësishëm brenda qeverisjes lokale. Por një raport i tillë nuk ka të dhëna të mjaftueshme se kjo zyre i ka realizuar përgjegjësitë e saja, se ka shpërnda 750 informacione ditore, për më pak se 200 ditë pune si kundër i ka përgatitë dy numra të Buletinit.

Në raport konstatohet se në këtë periudhë kryetari i komunës ka realizuar vizita të rëndësishme në Amerikë, Gjermani, Bruksel, Austri, Turqi, Zvicër, Shqipëri dhe vende tjera dhe i sjell Gjilanit "Çmimin e qytetit model për investime dhe pranimin në konventën e kryetarëve të komunave në Bruksel.

Në raport fare nuk bëhet fjalë, se sa herë kryetari i komunës për këto vizita ka raportuar në KPF dhe në kuvend, dhe cilët janë rezultatet dhe dobietë për komunën Gjilanit nga këto vizita.

Mangësitë e kësaj zyre janë:

1. Në raport fare nuk trajtohet çështja e realizimit të transparencës në punimet e organeve komunale.
 2. Fare nuk bëhet fjalë se si dhe sa zbatohet Udhëzimi Administrativ nr 05-2013 për transparencë në komuna.
 3. Në rregullat në vijim të udhëzimit administrativ të cekur më sipër përcaktohen përgjegjësitë e zyrës për informim:
Nen 3 paragrafi 3(njoftimi) për seanca të kuvendit të komunës(3.1; 3.2; 3.3)
Neni 6.5 , njoftim për takimet publike dhe neni 6.6 pjesëmarrja e zyrtarëve të lartë të komunës në diskutim është e obligueshme.
 4. Në periudhën raportuese janë miratuar në kuvend 6 rregullore, mirëpo me vetëm nga një debat.
 5. Organizimi i debateve është përgjegjësi e zyrës për informim(neni 7.3(3,1;3.2; 3,3))
 6. Planin e transparencës e harton dhe zbaton zyra për informim(neni 9), derisa edhe ky plan fare nuk akt ë dhëna se si zbatohet.
 7. Në zbatim e sipër është Rregullorja për Transparencë në Komunë. Kjo zyre fare nuk e trajton se si zbatohet kjo rregullore komunale.
 8. Kjo zyre është përgjegjëse edhe për zbatimin e procedurës për qasje në dokumente publike, neni 8. në raport fare nuk jepen të dhëna për qasje në dokumente publike për 9 muaj.
 9. Edhe në raportin gjashtë mujor nuk kishte ndonjë të dhënë për qasjen në dokumente publike.
- Z. kryetar në raportin e juaj në vitin e kaluar keni pas thënë: Pagesat ndaj operatorëve dhe autoriteteve të cilat i keni bërë në vitin 2014 kanë qenë 2.6 milion €. Sa euro janë paguar këtë viti në emrin e borxheve të mëhershme.

Nuk janë pak 780 mijë euro borxh që figurojnë, që nuk ka asnjë procedurë të prokurimit dhe nuk mund askush të krijojë borxhe më shumë se masa e caktuar me ligj. A keni krijuar ju gjatë këtyre viteve kësso lloj

borxhe dhe nëse po, cilat janë arsyet? Keni pohuar vitin e kaluar se keni arrit për ta përmirësuar buxhetin në tri kategori kryesore, në subvencione për bujqësi, investime kapitale dhe në programe e sidomos në arsim. Sivjet në cilat kategori keni përmirësuar buxhetin, teksa siç dihet sivjet bursa për studentë nuk ka dhënë komuna.

Komunës nuk i kanë borxh qytetarët, por i kanë borxh subjektet, kompanitë dhe borxhlinjtë më të mëdhenj të Komunës, e që janë operatorët. Masa më e vogël e borxhlinjve janë qytetarët, qoftë tatimi në pronë qoftë te taksat e ndryshme komunale. Sa janë realizuar borxhet nga këta operatorë gjatë vitit që e lamë pas dhe më çfarë projekte i keni shpërblyer këta qytetarë të ndërgjegjshëm?

Keni premtuar se reagimet për viti 2015 do të jenë rigorozë , duke pohuar se 54 ndërtues ilegal do të kenë problem, por edhe ndërtuesit e lartë do të kenë problem dhe nuk do të amnistohen as ata. Gjendja reale në qytet po na jep krejt një tjetër pamje dhe askush nuk u ndëshkua, mbase mund të ketë edhe shpërblime për këta që e kanë degradua qytetin.

Keni premtuar se do ndëshkohen të gjithë shkelësit e ligjit, prapë nuk ka zbatim të mirëfilltë të respektimit të ligjit për ndalimin e duhanit dhe kjo shkelje ligjore që vazhdon, ju atakon Juve si përgjegjës direkt për mos respektim.

Avdyl Aliu- e kam vetëm një replikë të shkurtër me kolegun Bujarin dhe mund të garantojë se gjatë tërë fjalës sime nuk e kam përdorur fjalën shkollë dhe as ndonjë emër të ndonjë shkolle dhe as që e kam përdor gjatë tërë fjalimit tim PDK. Është incizimi dhe mund të vërtetohet ajo!

Mirëpo se çfarë problemi ka Bujari me mua nuk e kam të qartë! Një që e kam vërejt është se kur ne takohemi në qytet (me Bujarin) , ai ndërron fizionomi dhe turbullohet. E kam pasur një rast që gjatë bisedës së zakonshme në sallë është kthyer brenda dhe ka deklaruar se më ka kërcënuar shefi i grupit të LDK-së e që është shumë e pavërtetë dhe rasti tjetër që është në një takim të KPF-së, unë për pa e marrë ende fjalën thotë më provokim shefi i grupit të LDK-së për pa folur unë fare.

Sa i përket ndërtimeve pa leje po e përmendi një shpifje, se një koleg i joni këtu, iu ka shpërndarë dezinformata medieive të ndryshme për ndërtime të objekteve pa leje, se gjëja ka pasur objekte pa leje, unë e kam sjell lejen këtu dhe e kam treguar një leje të një operatori dhe kam treguar se ja ku është leja. Mirëpo tash prapë pas disa jave është thirr KTV dhe është bërë një program dhe më fokuson te objektet që kanë leje ndërtimore. Unë nuk e di pse po e pengon ajo punë që po punohet aq shumë atje. Ato leje që po përmenden lëshohen në bazë të vendimit të qershorit të vendimit 2012 edhe korrik 2013. Është kryesuesi i atëhershëm, janë dy drejtorë dhe nëse shikojmë me përqindje janë 96 % këto objekte janë në atë mandat.

Ibish Iibishi- së pari më vjen keq prej kolegëve që janë para nesh dhe nuk shohin se kush e ka kërkuar fjalën dhe nëse vazhdojmë kështu duhet ta bëjmë edhe një monitor për të parë se a e ka kërkuar dikush fjalën apo jo!

Për sa i përket raportit që deri më tash u debatua disa vërejtje mund të jenë me vend dhe janë me vend, mirëpo nuk dëgjova asnjë fjalë prej kolegëve opozitar duke thënë se është bërë mirë këtu apo këtu! Asnjë punë e mirë nuk u tha nga opozitarë absolut. Ne e dimë se nëpër të gjitha vendet dhe lokalitetet e kësaj komuna është punuar dhe është duke u punuar, prandaj nuk është mirë që të merreni vetëm me vërejtje, por ne si qeverisje komunale duhet t' i marrim ato si sugjerime apo si këshilla për të bërë përmirësime në të ardhmen, sepse ndoshta diku kemi ngecur.

Si çështje e dytë nuk do të isha desh ta ceki si lokalitet as në Zhegër, Pogradje apo Malishevë ku është punuar dhe nuk është punuar, sepse në të gjitha lokalitetet është punuar diçka.. Jo aq sa duhet arsyeje janë të ndryshme, mirëpo nuk është ashtu siç po e paraqet opozita. Kjo po na bën se ne nuk jemi duke punuar dhe nuk jemi në nivel dhe po na bën për të dyshuar se a jemi ne duke qeverisur apo veç jemi aty si figura. Është e vërtetë se nuk është bërë e tërë ajo çka duhet dhe nuk mund të përmbushen të gjitha kërkesat e qytetarëve, sepse ka shumë të tilla, por dal ngadalë besoj se në të ardhmen do të mbërrijmë si koalicion qeverisës për t' i realizuar të gjitha planet që i kemi planifikuar edhe për të cilat po thuhet se është siguruar paraja dhe do të thotë se nëse ka para do të realizohen të gjitha. Po thuhet se projektet i keni gjetur të gatshme janë bërë në atë apo këtë kohë, por për mua nuk e di sa a është më me rëndësi që po realizohet një projekt, apo për ta ditur se kur dhe qysh ka ardhur?

Sipas disave projektet e mëparshme ka qenë deshtë të stopohen dhe të fillojmë me projekte të tjera dhe sa herë që të ndërrohet pushteti ne duhet të kthehemi në zero me projekte të reja. Duhet t'i themi secilit që ne askujt këtu nuk i kemi zënë rrugë! Askush askujt nuk mund t' i thotë se na e ke zënë rrugën, as mua nuk mund të më thotë askush as kryetarit dhe zv/kryetarit. Ne jemi këtu me votë të qytetarëve dhe disa janë në këtë Kuvend edhe në mandatet e tjera, por kjo gjuhë nuk është përdorur në mandatet e tjera, por tash ka filluar një gjuhë e komunikimit dhe kulturë e re e përdorimit të gjuhës në këtë Kuvend, por kjo është tolerim të cilin e ka bërë kryesuesja, prandaj unë të preferoj që në të ardhmen mos të bësh këso tolerance. Për këso akuza unë propozoj që të hapet një zyrë e gjykatës apo Prokurorisë dhe të gjithë ata që kanë akuza, para se të hyjnë në seancë le ta dorëzojnë lëndën në atë zyrë.

Sa i përket koalicionit vetëm një çështje e kisha dëshiruar që mos të ketë denoncim për korrupsion, por pse flet dikush pa argumente ajo shumë pak qon peshë.

Fatbardhë Selmani- si duket kryetari u inkurajua duke i dëgjuar “mbrojtësit” e tij dhe e liroi sallën dhe shkoi edhe pse fjala e tij ishte se do të qëndronte të paktën deri në fund të raportit, prandaj unë duhet t' i largoj disa pika që desha t' i them para fillimit të seancës. Një theks të veçantë po ia kushtoj Drejtorisë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale e cila drejtori me sa kam vërejtur ka bërë vetëm një kope-pest dhe na e ka sjell neve përpara. Përveç subvencioneve dhe projektit për dezinfektim dhe deratizimit asgjë më shumë nuk ka.

Po ashtu u pa që edhe projekti i dimërimit për familjet skamnore në vitin 2015 nuk është realizuar gjë e cila është shumë e nevojshme për familjet skamnore. Ne shumica këtu ndoshta nuk e dimë se çka do të thotë mirëpo ata të cilët kanë qëndruar në atë ftohtë aq të madh pa ngrohje dihet se çka do të thotë. Po ashtu po e shfrytëzoj rastin që nga drejtori i Administratës, sepse Zyra për Vaksionim e ka një problem shumë të madh që në këtë raport nuk është cek, por ata kanë problem me identifikimin e foshnjave të cilat lindin në Komunën e Gjilanit e nuk mund të vaksinohen, sepse nuk e dinë vendbanimin dhe vendndodhjen e tyre. Ata kërkojnë vazhdimisht që të kenë qasje në ofiqari, por atyre nuk iu është mundësuar kjo. Deshta ta dije se a është e lejuar kjo në bazë të ligjit apo jo? Nëse po, atëherë ju lus që t' i lejoni atyre qasje. Ka shumë probleme që duhet t' i them, por kryetari nuk është këtu dhe nuk kam kujt t' i drejtohem.

Arijetë Rexhepi – do t' i referohem disa drejtorive të cilat kanë raportuar për periudhën janar –dhjetor për vitin 2015 dhe së pari te Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Nga të dhënat e paraqitura për këtë drejtori nuk mund të vlerësohet performanca e kësaj drejtorie. Mangësitë në punët e kësaj drejtorie për periudhën raportuese janë se kjo drejtori është shquar me emërim të ushtruesve të drejtorëve të personave jo profesional të cilët nuk kanë asnjë performancë për ta drejtuar këtë dikaster të Administratës Komunale. Në fillim të mandatit është emëruar një infermiere, me Fakultet të Filologjisë (Letërsi dhe gjuhë shqipe), kurse më vonë është emëruar një inspektor sanitar me fakultet të bujqësisë, kurse tash një person me fakultet të shkencave politike e që nga aspekti profesional nuk ka kapacitet për ta udhëheq këtë drejtori. Kjo drejtori është angazhuar për pranimin e kuadrit fillestar mjekësor së bashku me CARITAS-in, por siç dihet ka pasur parregullsi gjatë pranimit të kuadrit dhe askush nuk jep llogari. Drejtoria nuk ka plan të punës për vitin 2015 dhe nuk ka pasur as më 2014.

Kjo drejtori as vitin e kaluar as këtë vit nuk ka shtruar ndonjë problem nga kompetenca e saj dhe nuk ka propozuar që të përfshihen në planin e punës të Kuvendit për vitin 2015. Janë dhënë shtëpi nga fondi i solidariteti dhe iu është paguar qiraja familjeve skamnore, por fare nuk paraqiten të dhënat sa mjete financiare janë grumbulluar në tërësi. Mandej nuk dihet se kush e menaxhon fondin, si bëhet përzgjedhja e kryesit të punës, kush e bënë përcjelljen e projektit dhe a ka pranim teknik t projektit?

Drejtorja e ka pasur për detyrë që kohë pas kohe t' i raportojë Komitetit për Shëndetësi, Kuvendit , por edhe opinionit dhe në këtë mënyrë do të jetë më transparente

Është paraqitur shuma e përgjithshme e investimeve kapitale në lartësi prej 80 mijë euro, por fare nuk thuhet se cilat projekte të investimeve kapitale janë realizuar në vitin 2015?

Te Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në raport është përfshirë vetëm një faqe për këtë drejtori dhe kjo është një pasqyrë shumë e ngushtë për ta pasqyruar angazhimin e kësaj drejtorie. Në tabelë shihet se numri i lëndëve është rrit për 618 dhe numri i lëndëve në krahasim me 2014 dhe 2015, numri shtohet për 1 mijë lëndë. Efikasiteti i zgjidhjeve të lëndëve në këtë drejtori është nën nivel dhe ka mangësi të mëdha. Aspak nuk

trajtohen lëndët e uzurpimeve arbitrare në këtë raport. Edhe pse është mjaft i moçëm negativ (uzurpimet) që nga pas lufta kjo drejtori nuk i ka kushtuar rëndësi. Çështja e uzurpimeve nuk është shqyrtuar në asnjë instancë dhe në asnjë komitet dhe as në Kuvend edhe pse është kërkuar nga opozita. Kjo drejtori nuk është marrë fare me kompensim të sipërfaqes tokësore prej 13 hektarëve e cila është shfrytëzuar për rregullimin e rrugës qarkore. Ky rast paraqet shkelje të drejtave të njeriut (uzurpim i tokës) dhe kjo çështje kërkon një zgjidhje urgjente në bashkëpunim me MF-në.

Te Drejtori e Urbanizmit e kemi një hapësirë prej 4 faqesh e që në fushën e planifikimit përmenden disa plane rregulluese urbane të hollësishme, por fare nuk ka sqarime se si do të bëhet realizmi i tyre?

Në fushën e Mbrojtjes së Mjedisit në raport nuk ka të dhëna konkrete, sepse në këtë lëmi me siguri nuk është bërë asgjë konkrete. Në sektorin e Inspektimit nuk epen të dhëna se sa objekte pa leje janë rrënuar dhe cilat janë arsyet e mos rrënimit të tyre. Kjo tregon se sektori i inspeksionit nuk është në nivelin e detyrës.

Mangësi tjetër e urbanizmit është se nuk ka raportuar në KPF dhe në Komitet për Planifikim Hapësinor nga Komisioni për emërtimin e rrugëve.

Krenare Latifi- Drejtoria për Zhvillim ekonomik- në një hapësirë shume te vogël prej 2 faqesh është paraqitur aktiviteti i kësaj drejtorie. Qe ne fillim te raportit ne pika te raportit paraqitet bashkëpunimi me shume mekanizma ndërkombëtare (Usaid) Komisioni evropian, GIZ , Help etj. Pastaj komuna e Gjilanit ne panairin ndërkombëtar ‘ ‘ Menaxhment Investment Exhibishën , ka marre çmimin ”The Best City model Award ,, mirëpo nuk paraqiten se cilat janë rezultatet konkrete ne zhvillimin e komunës se Gjilanit ne vitin 2015 nga ky bashkëpunim.

Projekti PPP i Kompleksi i shkollave , për këtë projekt me vite te tera qysh ne mandatin e kaluar ka qene i gatshëm për Implementim dhe ende nuk ka filluar. Kjo drejtori duhet japë arsyetimin se pse ne raport fare nuk behet fjale se deri ku ka arritur procedura për themelimin e “NP Tregu”.

Drejtorja për Mbrojtje dhe shpëtim– Ne faqen 26 – 27 te raportit te kryetarit te Komunës për vitin 2015 vetem ne një hapësirë prej 1 faqe është përfshire ne mënyre te përgjithshme i gjithë aktiviteti i drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim për vitin 2015.

Kuvendi ka miratuar edhe planin operativ emergjent komunal.

Mangësitë e pranishme te kësaj drejtorie ne periudhën e kaluar si mungesa e aktiviteteve është vërejtur se:

- 1) Statusi i pa rregulluar i zjarrfikësve p.sh. një numër i zjarrfikësve ende janë te punësuar me kontrata ne vepër, gjë qe është ne kundërshtim te plote me ligjin.
- 2) Ne raport nuk jepet vlerësimi për gjendjen e mbrojtjes nga zjarri
- 3) Ne raport konstatohet se ne vitin raportues ka filluar aktiviteti me drejtorin e arsimit për aftësimin e 3 nxënësve dhe te arsimtareve për mbrojtjen nga zjarri
- 4) Si behet aftësimi kur ne drejtorin e arsimit nuk janë te furnizuara me pajisje për mbrojtje nga zjarri i tere aktiviteti i kësaj drejtorie te kësaj periudhe Janar-Shtator/2015.
- 5) Institucionet publike fare nuk janë te pajisura me pajisjet e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri (gjë që është shume e nevojshme)
- 6) Nuk ka një vlerësim objektiv se objektet shume katesh janë të panisura me shkallet emergjente.

Këto janë disa nga sugjerimet e domosdoshme qe drejtoria përkatëse se bashku me kryetarin e komunës duhet ti trajtojnë si nevojë me prioritet dhe mos te na sjellin raporte te mangëta siç është ky i fushës se drejtorisë se mbrojtjes dhe shpëtimit.

Drejtorja për buxhet dhe financa – Kjo drejtori njëra nder drejtoritë me te rëndësishme në kuadër te administratës komunale, por veprimtaria e saj gjate vitit te kaluar është trajtuar ne një hapësirë vetëm prej 2 faqesh ne raportin e punës. Ne faqen 16 dhe 17 te raportit te punës se kryetarit Janar-Shtator/2015 është trajtuar aktiviteti i drejtorisë për buxhet dhe financa. Kjo është një hapësirë shume e vogël për te paraqitur punën e kësaj drejtorie e cila vlerësohet ne baze te kompetencave te saja se është drejtoria me e rëndësishme ne përbërjen komunale. Ne vetëm 34 pika është paraqitur

Si vitin e kaluar edhe këtë vite drejtoria për buxhet dhe financa ne krye edhe me kryetarin e komunës ne këtë qeshje ka dështuar. Shpenzimet kapitale ne buxhetin e vitit 2016 kapin shumën prej 3.432.288 euro dhe kjo shume sipas fushave te administratës komunale është shpërndarë neper drejtori. Mangësia themelore e

kësaj mënyrë të shpërndarjes destinimit të shpenzimeve kapitale qëndron në faktin se ato nuk figurojnë në vendimin për miratimin e buxhetit, nuk janë destinuar për projekte konkrete. Duke e përcaktuar emërtimin e projektit dhe shumën e projektit. E njëjta çështje qëndron edhe me mjetet për subvencionimin në lartësi prej 674.000 euro të shpërndara në 6 fusha të administratës komunale. Edhe këto mjete të planifikuara buxhetore për vitin 2016 fare nuk janë të destinuara për projektet kapitale. Drejtoria e shërbimeve publike është përcaktuar shuma e përgjithshme 876.000 por pa i përcaktuar destinimet për projekte komunale. Mënyra e tillë e shpërndarjes së mjeteve financiare buxhetore pa konkretizim të projekteve. Në pjesën e raportit të punës së KK për periudhën Janar-Shtator/15 ku trajtohet aktiviteti i departamentit të prokurimit janë përfshirë 106 projekte për të cilat janë nënshkruar 86 Kontrata, Paraqitet pyetja si ka mundësi departamenti i prokurimit të hartojë planin vjetor të prokurimit të vitit 2015 ku projekte të tilla nuk kanë qenë të përfshira në vendimin e buxhetit për vitin 2015, pastaj ky plan fare nuk është trajtuar në KPF dhe në Kuvend.

Sahit Abazi- së pari iu bëjmë me dije se si grup i PDK-së do të votojmë kundër këtij raporti për arsyet që u thanë nga të gjithë anëtarët e grupit tonë. Mirëpo para se t'i them edhe unë disa fjalë dua t' i them dhe t'ia kujtoj një person që e keni shpall Qytetar Nderi, sepse ju e keni shpall Qytetar Nderi, z. Ilir Meta dhe shpesh do të na bie ndërmend, sepse sot do t' i përdori dy shprehje të tij, sepse kur është llugë skena politike, ai i përdor mirë këto dhe e para thotë:” me qetësi dhe dashuri”dhe e dyta thotë:” aty ku ju shihni duele, unë shoh duete”. Ilir Meta nuk është politika i modelit tim, por këto dy shprehje janë të vërteta, sepse ne me LDK-në përveç që kemi duele, kemi edhe duete të përbashkëta.

Gjatë debatit u tha se pronën publike në kur jemi në pushtet nuk e japim për ndërtim, dua të iu rikujtoj se LDK e ka votuar PPP-në kur ka qenë në opozitë dhe e ka votuar kur është bërë objekti.

Gjithashtu një përmirësim të lehtë se unë pavarësisht faktit, unë si ekonomist kam qenë kundër atij partneriteti dhe ai ka qenë qëndrim im personal, kurse LDK, atëherë ka pasur qëndrim institucional dhe e ka votuar për. U përmend kadastrë, hetime e nuk e di çka, por i sugjeroj kryetarit të Komunës më mirë është të merret me dënsaurin e që është ndërtuar përballë spitalit, një objekt që e shëmbet tërë këtë qytet e për të cilin kemi faj të gjithë faj nga pak, por që është mirë të merreni me të, sepse është një ndërtesë e cila në fillim të qytetit të Gjilanit i shkakton neveri njerëzve. E thatë se për Lumin Mirusha se PDK, nuk ka bërë asgjë, por unë po iu rikujtoj edhe një kujtim të lehtë se 7 vjet para neve keni qenë në pushtet dhe nuk ia keni filluar asaj pune. Më vjen keq që kryetari shumicën e raportit e pati me atë që e tha zonja Shukrie me kohën e ardhshme dhe unë sugjeroj që në raportin e ardhshëm të jetë : Raport dhe plan i punës, sepse dallojnë, nëse është raport duhet thënë vetëm se çka ka ndodhur, nëse është plan i punës do të tregojmë se çka do të bëjmë.

Besoj se kryetari e kupton se debati i sotëm duhet të merret me “qetësi dhe dashuri”dhe unë jam i mendimit dhe kërkoj që në një të ardhme ta trajtojmë temën e pa papunësisë. I kemi 19 mijë njerëz të pa punë dhe 3 mijë prej tyre janë me shkollim superior. Këta 19 mijë janë lajmëruar në Ent të Punësimit dhe i kemi disa mijëra të tjerë që nuk janë lajmëruar. Mirëpo një fakt tjetër që na shqetëson është se kemi me mijëra ekonomistë dhe juristë e të cilët po na shërbejnë neve dhe për mua kjo është gjendje trishtuese, sepse e dimë që disa kanë shkollë edhe më shumë dhe sinqerisht ndihem keq. Shpresoj dhe besoj se në raportin e ardhshëm të kemi saktësi më të madhe në raportin e punës edhe kur flet për projektet e qeverisjes së kaluar. Këtu është një detal interesant, sepse thuhet do të fillojmë për t' i bërë edhe kontrollet sistematike nëpër shkolla. Ky ka qenë projekt i PDK-së, ju e keni ndal dhe tash po e rifillon? Gjithashtu pasi që jam me prejardhje nga Bresalci, po iu rikujtoj kryetarit se i kishte premtuar drejtorit të shkollës në Bresalc se në mandat tëndin do ta përfundojmë sallën e sportit, por atij drejtori i kanë mbet edhe dy vite mandat, kurse salla e sporteve është në gjendje jashtëzakonisht të keqe. Në Velekicë e tha edhe Bujari se është punësuar i 14 dhe jo i pari dhe ky rast është në hetime, sepse diferenca është shumë e madhe, prandaj është mirë kryetari të merr masa dhe ta kthejë atë që e ka merituar për të qenë në punë.

Luftfi Haziri- unë e dhe një numër i aëtarëve kanë pasur se çka të thonë, por sot është raporti, prandaj këta si këshilltarë të kryetarit, në seancat e radhës mund t' i paraqesin atë që kanë pasur ndërmend për ta thënë.

Unë iu falënderoj të gjithëve për rekomandimet, sugjerimet dhe vërejtjet për përmirësim të këtij raporti.

Raporti si i tillë pasqyron politikat sektoriale, njësitë, mënyrat se si punoj. Unë punoj në ekip dhe punoj me detyra të deleguara, vazhdoj të punoj në këtë mënyrë dhe kam parë se shumë punë kanë mbetur për pa u evidentuar e që disa janë punë ditore, punë sipas detyrës zyrtare, angazhime konkrete ë kërkohen për çdo vit të përsëriten. Një fjalë e popullit është për politikanët dhe për ata që kërkojnë të zhvillohen “ faleminderit nuk ka “. Nuk është diçka që njerëzit e tanë nuk e kanë merituar, investimi bëhet me një rrugë, me një kanalizim me një shkollë dhe ajo punë kryhet dhe për atë punë as nuk ka nevojë të thuhet faleminderit, as të bëhet e madhe, sepse ajo është kryer, prandaj gjithmonë flasim për punë të papërfunduara. Natyrisht që i nënshtrohet monitorimit puna, serioziteti në zbatim të detyrës dhe gjithmonë duhet të kemi më shumë për të pasur mundësi për të realizuar. Gjilani në këto dy vite është anëtarësuar në dy organizata ndërkombëtare, jashtëzakonisht të rëndësishme dhe është Konventa e Kryetarëve të Evropës në të cilën konventë ne jemi anëtarësuar dhe e kemi nënshkruar deklaratën dhe kemi marrë zotimet që bazohen për përmirësimin e efijencës së energjisë elektrike dhe reduktimet e të cilat ne do t' i fillojmë për t' i zbatuar nga ky vit.

E dyta organizatë është me seli në Strasburg dhe Bruksel dhe është Agjensioni për Demokraci Lokale e cila Gjilanin e ka pasur partner, por tash e ka anëtarësuar e që ne besojmë se partneriteti do të zhvillohet në mbështetje të politikave lokale për nevojat specifike të Komunës. Unë zotohem para jush se do të paraqesim raport tre mujor me shkrim, kurse mandator është raporti gjashtë mujor i cili do të vijë në Kuvend dhe do të paraqitet në Kuvend me shkrim dhe me gojë. Në fund po flas për dy çështje kryesore e që është Lumi Mirusha. Lumi Mirusha është një projekt i cili (nuk më vjen keq për të thënë) se po i përngjan Urës së Shenjtë, por e kemi bërë një gabim që nuk i kemi thënë ura e maskatarit , por po i themi Lumi Mirusha. Për këtë lumë ne e kemi bërë revidimin e projektit vetëm në pikat ku preket shpronësimi përmes KK-së dhe i kemi ikur shpronësimit, sepse është kosto e shtrenjtë dhe janë milionë euro të planifikuara për shpronësim. Mirëpo përderisa nuk kemi këto mjete jemi peng i shpronësimeve, prandaj ne i kemi ikur pjesës kryesore ashtu siç është vepruar mbyllja e lumit deri tek Hoteli dhe nuk ka qenë me plan për t' u mbyll as aty, por është mbyll. Arsyet janë të njëjta, ai Lumë në sezon të verës nuk ka ujë. Alternativën e kam biseduar me projektuesin dhe alternativa është në Livadhet e Koretisthës hulumtimet e ujit të pijshëm të përdoren, ku nuk ka nevojë për ujë të pijshëm kur nuk ka mund të përdoret për rrjedhje në lumë. Në vijim të fjalës, kryetari në hollësi e sqaroi projektin e këtij lumi dhe revidimit të këtij projekti. Nuk ka më mjete nga Qeveria për këtë lumë, ky projekt mbulohet nga projekti i Komunës së Gjilanit me Qeverinë e Austrisë dhe për këtë vit janë planifikuar 2 milion euro për projektin e këtij lumi.

Qeveria nuk e ka financuar për ta mbyllur, prandaj kemi kërkuar që me mjete tona do të jetë përgjegjëse dhe do të hyjë në obligime financiare në mënyrë që të realizohet njëherë e përgjithmonë, kurse mjetet tjera shkojnë për Lumën Stanishorka i cili është i njëjti problem për Gjilan dhe integrimi i rrjetit të kanalizimit për tërë qytetin.

Gjilani ka dal si Komunë me zero uzurpim me pronë publike, zero uzurpim pronë shtetërore, por ka problem me pronë komunale. Uzurpim të pronës komunale e për të cilat unë jam i zotuar për t' i marrë të gjitha masat aty ku ka uzurpim të pronës komunale dhe do të merren masa ligjore, ndaj atyre që kanë bërë uzurpime.

Ne në këtë fazë do të marrim masa me Inspeksionin dhe me aksionin për rrënim të objekteve dhe do të filloj rrënimi pa marrë parasysh se çfarë standardi dhe në cilat kushte është. Lirimi i pronës do të ndodh për çdo pjesë që nuk e prek legalizimi. Lista e solidariteti u përmend, por lista e solidariteti, donatorët janë në ueb sajd të Komunës dhe secili mund t' i shoh kush sa mjete i ka dhënë dhe aty janë edhe mjetet e pashfrytëzuara e që janë mbi 200 mijë euro. Problemi me zjarrfikësit, problemi me punëtorët teknik të shkollave fillore dhe të mesme, janë probleme që janë trashëguar dhe po mundohem në vitet në vijim për t' i zgjidh. Punëtorët teknik janë pranuar me konkurs publik, por më vonë kanë kaluar në sektorin privat. Mjetet e planifikuara për punëtorët teknik iu kanë ndarë arsimtarëve dhe është bërë ndarja e normave. Ata mund të kërkojnë të drejtën e tyre në gjykatë dhe mund të fitojnë. E njëjta është edhe me zjarrfikësit, sepse ata janë zjarrfikës vullnetar të organizuar si OJQ, por që kanë marrëveshje me Komunën dhe kjo marrëveshje është plotësim i brigadës së zjarrfikëseve për një numër të caktuar e që kanë qenë 11 dhe tash janë 9. Agjensioni për Menaxhimin e Situatave është ai i cili duhet për ta zgjidh këtë problem. Përfundimisht t' ia pranojë statusin e zjarrfikësve ose për ta shuar këtë mundësi, sepse ne nuk kemi mundësi për t' i dhënë mijëra euro paga për këtë njësi, apo për këtë ekip prej 9

personave. Këto janë probleme që kërkojnë zgjidhje dhe do të vijë koha që ose do të largohen të gjithë ose duhet bërë një zgjidhje në kuadër të mekanizmave që sot janë.

Plani zhvillimor komunal duhet të ndërtohet mbi gjendjen reale që e ka sot Komuna e Gjilanit dhe ky Plan zhvillimor është më i vjetër se 6 vjet, por në kohën që po jetojmë tash qofshin ato të tipit të objekteve dinozaurë, objekteve të mbetura të papërfunduara rishikimi i disa planeve rregullative, sepse gjendja ka ndryshuar. Sipas Planit urban, rruga e Prishtinës dhe lagjja e sajë, është krejt në tjetër mënyrë e organizuar dhe gjendja reale është krejt tjetër, por ne nuk kemi të drejt për t' i dhënë leje askujt dhe as nuk mund ta shpronësojmë rrugën. Unë ftoj që Planin zhvillimor ta hartojmë së bashku në mënyrë që Gjilanit t' i japim dimension tjetër dhe të punojmë bashkë dhe ta zhvillojmë për aq sa kemi mundësi.

Me fjalën e kryetarit përfundoi debati për pikën e parë të rendit të punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.1. e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.1 e rendit të punës : Raporti i punës janar- dhjetor 2015 i Kryetarit të Komunës, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 6 ishin kundër, kurse të tjerat ishin abstenime.

Pas kësaj pike të rendit të punës kryesuesja i liron anëtarët e Kuvendit në ora 14.30-15.30 në pushim të drekës.

2.2. Propozim vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2014 dhe 2015, në vitin fiskal 2016

Zijadin Maliqi-është e ditur se për çdo vit bëhet bartja e mjeteve nga viti paraprak, në vitin vijues, prandaj këtë vit kemi një bartje të mjeteve prej mbi 1 milion 4 mijë euro e që e kam thënë edhe në KPF se mund të ndryshojë për 2 mijë euro në krahasim ma atë që e kemi pasur në KPF, sepse në MEF, janë bërë dy gabime me fajin e tyre dhe deri të premten kemi bërë presion që ta përmirësojnë gabimin e tyre dhe ky përmirësim është bërë dhe tash është gjendja 1 milion e 4 mijë 324 euro. Këto mjete që kanë mbetur janë mjet të gjysmës së nëntorit në shumë prej mbi 221 mijë euro, pastaj janë edhe mjete të dhjetorit mbi 370 mijë euro dhe 18 mijë 160 euro nga gjobat e trafikut që kanë ardhur në fund të dhjetorit. Mbi 164 mijë janë nga gjobat prej gjykatave e të cilat kanë ardhur nga gjysma e janarit të këtij viti si dhe mbi 3 mijë e 100 euro nga Agjensioni Pyjor e të cilat kanë ardhur në janar të këtij viti. Gjithsej mjete të dhjetorit dhe nëntorit janë mbi 780 mijë euro, kurse mjete të bartura të zotuar që kanë qenë më herë janë mbi 220 mijë euro e që janë mjete nga projekte të ndryshme e të cilat janë zotuar, por nuk janë shfrytëzuar ato mjete. Këto mjete janë dhe ne po përpiqemi që t' i zbatojmë ligjet të cilat e rregullojnë sferën e financave.

Këtyre mjeteve nuk mund t' ia ndërrojmë strukturën e mjeteve, kategorinë e tyre, prandaj për atë kategori ku kanë mbetur për atë kategori edhe janë shpërndarë. Të dhënat në hollësi për këtë pikë, anëtarët e Kuvendit i kanë në materialet e tyre.

Përkitazi me këtë pikë e morën fjalën: Isa Agushi, Nevzad Isufi, Riad Rashiti, kurse në fund u përgjigj në pyetje të tyre drejtori Zijadin Maliqi.

Pas përfundimit të debatit për këtë pikë të rendit të punës, kryesuesja kërkoi që të aprovohet pika 2.2/

Aprovohet pika 2.2: . Propozim vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2014 dhe 2015, në vitin fiskal 2016, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

2.3. Propozim vendimi për garancion të qëndrueshmërisë operative dhe financiare për Ndërmarrjen në themel "Tregu" në Gjilan

Agim Zuzaku- ky është në propozim-vendim për garancion të qëndrueshëm operativ -financiar për ndërmarrjen tregu në Gjilan. Më datë 18.6.2015, Komuna e Gjilanit e ka bërë një kërkesë, përkatësisht njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për ta themeluar Ndërmarrjen e re Tregu. Pse është kërkuar ky garancion është për shkak të plotësimit- ndryshimit të ligjit të ndërmarrjes publike lokale e që është shtuar një paragraf në nenin 5 të rregullores bazë dhe pas

paragrafit 9 është paragrafi 10 e që është shtuar me këtë tekst: “ Komuna duhet të garantojë me shkrim përmes nënshkrimit të kryesuesit të KK-së dhe kryetarit të Komunës për investime dhe qëndrueshmëri operative dhe financiare në përputhje me kornizën afat mesme të shpenzimeve të Komunës që e ka paraqitur kërkesa “

Ne i kemi paraqitur me 18.6.2015, kërkesën tonë për ta themeluar këtë ndërmarrje dhe tani është kërkuar që të ripërsëritet, kurse ne i kemi plotësuar të gjitha kriteret e tjera të nevojshme duke paraqitur edhe raportin për qëndrueshmëri financiare dhe operative të ndërmarrjes, strukturën organizative, planin e biznesit, planin e buxhetit si dhe draft-statutin dhe dokumentet e tjera të cilat kanë qenë të bashkëngjitura.

Duke u bazuar në këtë arsyetim, kërkojmë nga KK që të merr vendim ashtu siç është përshkruar edhe në diapozitivin e tij e që është në përputhje me nenin 5 të rregullores së lartpërmendur të aprovohet kërkesa e jonë për t’i hap rrugë themelimit të ndërmarrjes së re publike Tregu SHA.

Për këtë pikë të rendit të punës fjalën e morën: Jonuz Hasani, Riad Rashiti, Nevzad Isufi, Selami Xhemajli, Riad Rashiti dhe përsëri Agim Zuzaku.

Pas të gjitha debateve, kryesuesja e Kuvendit kërkon nga anëtarët që të aprovohet pika 2.3 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.3 e rendit të punës: Propozim vendimi për garancion të qëndrueshmërisë operative dhe financiare për Ndërmarrjen në themelim “Tregu” në Gjilan, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kure 10 ishin kundër, të tjerët abstenuan.

2.4 Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës “Hendikos” në Gjilan

2.5 Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës “Hendikos” në Gjilan

Valentinë Bunjaku – Rexhepi- vendimi është marrë nga ky Kuvend që pikat 2.4, 2.5, diskutohen në bllok, prandaj fjalën e ka drejtori i shëndetësisë

Nexhat Hajrullahu- në komitet ka kaluar propozimi për të dy shoqatat pasi që janë dorëzuar raportet me shkrim për vitet paraprake, kurse vitin e kaluar ka pasur marrëveshje ose Memorandum Mirëkuptimi me Komunën, por edhe këtë vit vazhdon ky memorandum në këtë mënyrë me shoqatën Hendikos dhe ma atë “Pema”. Këto dy shoqata aktivitetet i kanë të përafërta, por “Pema “ merret me edukim ditor të personave me nevoja të veçanta dhe me aktivitet ditor.

Për pa e përfunduar fjalën drejtori i shëndetësisë, kryesuesja i liron anëtarët e Kuvendit në një pushim prej 10 minutave.

Pas pushimit, kryesuesja i njofton anëtarët e Kuvendit se zyrtari i këtij Kuvendi (Sali Hasani) do të shkojë në pension dhe kjo është seanca e tij e fundit, prandaj e thërras që ta merr një dhuratë modeste duke i uruar pension të merituar.

Në emër të grupit të PDK-së z. Salihun konkretisht mua, më përshëndeti z. Izmi Zeka dhe theksoi se për neve ka qenë kënaqësi që 6 vite e më tepër kemi punuar me bacën Sali i cili e ka kryer punën me dinjitet dhe me profesionalizëm, prandaj i uroj jetë të më të gjatë, sepse po del në pension në kohë të paqes dhe në kohë kur e kemi bërë shtetin dhe institucionet. Të falënderojmë për të gjitha.

Në emër të LVV z. Salihun e falënderoj z. Fehmi Sylejmani

Në emër të AAK-së një falënderim ia bërë Selami Xhemajli

Salihu konkretisht (unë) i falënderova të gjithë anëtarët e Kuvendit, duke i dëshiruar që të gjithë ta presin këtë ditë dhe ta gëzojnë së bashku me fëmijët nipat dhe mbesat e tyre.

Seanca i vazhdon punimet, kurse fjalën e kishte ndërpre drejtori i shëndetësisë i cili tash duhet ta vazhdojë.

Nexhat Hajrullahu- sa i përket për dy pikat që po i diskutojmë në bllok mendoj se është e qëlluar, sepse temat janë të ngjashme, kurse disa çështje do të debatohen në mbledhjen e ardhshme kur do të dorëzohen raportet. Në kuadër të këtyre dy shoqatave është bërë edhe një disiplinë buxhetore, sepse në të kaluarën ka pasur shpenzime enorme të rrymës, prandaj e kemi bërë një disiplinë dhe kontroll më të rreptë. Brenda një muaji ka ndodhur që janë bërë 1600 euro, rrymë, kurse tash ka zbritur në 50 euro.

Për këtë pikë të rendit të punës fjalën morën: Jashar Jashari, Leonorë Bunjaku, Bujar Nevzadi, Sahit Abazi dhe Krenare Latifi.

Pas përfundimit të debatit për këtë pikë, kryesuesja kërkoi që të aprovohen pika 2.4 dhe 2.5?

Aprovohen pikat 2.4 dhe 2.5: 2.4 Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës “Hendikos” në Gjilan dhe

2.5 Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës “Hendikos” në Gjilan, me 31 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse nuk ishte kundër

2.6. Propozim vendimi për Qasjen e ndërrimit të destinimit-Revidimit të një pjesë të Planit të Hollësishëm Urban: ” Kodra e Thatë” (QKMF)

2.7 Propozim vendimi për Qasjen e ndërrimit të destinimit-Revidimit të një pjesë të Planit Zhvillimor Urban: ” Qyteti i Gjilanit” (Shtëpia për të moshuarit)

Valentinë Bunjaku Rexhepi- edhe për këto dy pikë jemi patuar që të debatojmë në bllok, prandaj e lus shefin e Sektorit të planifikimit të Drejtorisë së Urbanizmit për ta marrë fjalën.

Fadil Sherifi-unë sot e përfaqësoj Drejtorinë e Urbanizmit në emër të drejtorit dhe jam shef i Sektorit për Planifikim. Në këtë pikë 2.6 është fjala për qasjen e ndërrimit të destinimit të një pjese të Planit detal urbanistik, Planit rregullues urban “Kodra e Thatë”. Në këtë lokacion është aprovuar Plani rregullues urban më 2010, mirëpo për qasje të revidimit patjetër duhet të zbatohen procedurat. Për këtë arsyeje nga DUMM ka qenë e nevojshme të propozohet lokacioni në vendin e caktuar ku e keni grafikisht të definuar në planet e juaja. Në këtë lokacion janë 30 ari e që i plotëson kushtet në minimum për QKMF “Nagip Rexhepi” në Gjilan. Me plan rregullues ka qenë e paraparë për banim kolektiv me etazhitet P+6.

Sa i përket pikës 2.7 po e jap një sqarim, sepse është një donacion nga Holanda e që do ta bëjë një investim për Shtëpi të Moshuarave në Komunën e Gjilanit dhe tri vjet do të financohet nga Holanda. Pas tri vite këtë shtëpi do ta menaxhojë Komuna. Përfaqësuesit e Holandës kanë ardhur me vonesë në Gjilan, kurse ne nuk kemi pasur dëshirë që të dalim jo serioz dhe ata kanë kërkuar garancion se do t’i ndahet prona. Kjo ka qenë vullneti i mirë edhe i kryetarit dhe i të gjithë neve që ta përfitojmë këtë donacion.

Për këtë pikë të rendit të punës fjalën e morën: Nevzad Isufi, Jashar Jashari, Izmi Zeka, Nevzad Rushiti, Rina Ahmeti, Sahit Abazi, Bajram Hasani, Arijetë Rexhepi, Leonorë Bunjaku, Fehmi Sylejmani dhe në fund përsëri Fadil Sherifi.

Pas që përfundoi debati, kryesuesja kërkoi që të aprovohet pika 2.6 dhe 2.7 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.6 dhe 2.7 e rendit të punës: **2.6.** Propozim vendimi për Qasjen e ndërrimit të destinimit-Revidimit të një pjesë të Planit të Hollësishëm Urban: ” Kodra e Thatë” (QKMF)

2.7 Propozim vendimi për Qasjen e ndërrimit të destinimit-Revidimit të një pjesë të Planit Zhvillimor Urban: ” Qyteti i Gjilanit” (Shtëpia për të moshuarit), me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

2.8. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për nevoja të ndërtimit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjilan.

2.9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për nevoja të ndërtimit të “Shtëpisë për të Moshuarit” në Gjilan.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- edhe për këto dy pikë u dhanë sqarimet, unë po e hap debatin dhe së pari për sqarime e lusim drejtorin që ta merr fjalën.

Sadudin Berisha- pika 2.6 dhe 2.7 ka të bëjë vetëm me qasjen dhe të drejtën e fillimit të ndryshimit përkatësisht plotësimit të planit aktual në fuqi të planit aktual në qytet. Nevojat janë të paraqitura në bazë të kërkesave të caktuara dhe ne si drejtori mbi bazën e përgjegjësisë që i kemi dhe menaxhim me pronën komunale, në koordinim me kryetarin e Komunës si autoritet i parë i nismës për fillimin e procedurave për zhvillimin e atyre hapësirave, kemi gjet lokacionet ku do të mund të realizoheshin dy projekte kapitale për Komunën e Gjilanit siç është QKMF e që më parë është paraparë në Fidanishte I, por për shkak të kontesteve pronësore nuk mund të realizohet, por ajo është procedurë ligjore që do të duhej Komuna t’ i nënshtrohej procedurave të shpronësimit dhe një sipërfaqe prej 30 ari me një vlerë minimale të çmimit të tregut prej 200 euro, atëherë na duhen së paku 300 mijë euro mjete financiare për ta realizuar një projekt të tillë siç është QKMF.

E vetmja alternativë në pjesën e ngushtë të qytetit është hapësira ku realisht e kemi një plan zhvillimor detal urbanistik është pronë komunale dhe asnjë cenet nuk do t’ i jep komuna për shpronësim dhe se në atë hapësirë është menduar të rregullohet me Planin detal urbanistik ndërtim kolektiv. Mirëpo ai plan bie në kundërshtim me ligjin për mënyrën e shfrytëzimit të pronës publike komunale. Ne i kemi ofruar si alternativë 50 ari për të mos u ngushtuar fyti i hapësirës dhe tani DUMM mbi bazat që do të aprovohet do të përkufizohet në hapësirën e saj sa i nevojitet dhe pjesa tjetër nuk do të preket.

E dyta çështje sa i përket Shtëpisë së Moshuarave, lokacioni është caktuar, procedurat kanë filluar dhe rekomandimet janë bërë nga Komiteti për Pronë dhe Gjeodezi.

Sa i përket raportit të kryetarit, mos të harrojmë se përderisa Komiteti për pronë Gjeodezi dhe Kadastër e ka miratuar Raportin e punës së drejtorisë 100% me pozitë dhe opozitë me mbi 4 faqe, sot dilet me zhargonin shtet politik se drejtorja e ka bërë këtë apo atë. I keni materialet, punoni keni qasje dhe të jeni konstruktiv.

Sa i përket PPP-së që u tha se është miratuar edhe nga anëtarët e Kuvendit, kjo është vërtetë edhe për Kadastër edhe te Kombinatin i Duhanit, por kemi miratuar një vendim për interesa publike, por çka ka bërë pushteti më vonë nuk kemi qasje?

Përkitazi me këtë pikë e morën fjalën: Izmi Zeka, Ibish Ibishi, Fehmi Sylejmani .

Pas përfundimit të debatit, kryesuesja kërkoi që të aprovohet pika 2.8 dhe 2.9 e rendit të punës

Aprovohet pika 2.8 dhe 2.9 e rendit të punës: 2.8. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për nevoja të ndërtimit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjilan.

2.9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për nevoja të ndërtimit të “Shtëpisë për të Moshuarit” në Gjilan, me, me 25 vota të anëtarëve të Kuvendit, 2 ishin kundër, kure të tjerët abstenuan.

2.10. Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të objektit arsimor- shkollë fillore sipas PRRU “Dheu i Bardh-2” – Gjilan

Sadudin Bersha -kjo pikë ka kaluar në Komitetin për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër dhe në KPF dhe kemi të bëjmë me një pronë komunale private të një personi (Fatmire Adem Shabani) në sipërfaqe prej 314 m² e cila pronë me Planin detal rregullues urban të Lagjes “Dheu i Bardhë II” parashihet infrastrukturë ndërtimore publike. Kudo që kemi plane rregulluese urbanistike duhet detyrimisht t’ i nënshtrohemi procedurës

shpronësuese. Për këtë rast zonja Fatmire ka kërkuar nga DUMM dhënien e lejes për ndërtim të një shtëpie e që është rast social, por edhe kjo sipërfaqe që është pronë formale, është dhuruar nga të tjerët, nuk është pronë e trashëguar apo e blerë prej sajë. Për këtë arsyeje ne si Komunë jemi të detyruar që t' i fillojmë procedurat e shpronësimit të pronave private për realizmin e projektit zhvillimor të asaj zona të caktuar. Në pamundësi të shpronësimit të tërë sipërfaqes për shkak të kostos së lartë financiare dhe duke pasur parasysh rastin e rëndë social dhe mundësinë që Komuna ta bëjë një këmbim të pronës private ma atë publike dhe fatmirësisht ajo pronë është afër pronës komunale që shpronësohet, kemi rekomanduar që të bëhet këmbimi i pronës në mes të asaj private dhe publike duke i mundësuar asaj qytetare realizmin e interesit të sajë vital (ndërtimin e shtëpisë), gjithashtu mbi bazën e Planit detal urbanistik. Në pjesën grafike e keni të definuar se ku duhet të bëhet këmbimi? Punë e jona është që ta bëjmë këtë këmbim deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar

Nuk pati vërejte dhe sugjerime, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.10 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.10 e rendit të punës : **2.10.** Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të objektit arsimor- shkollë fillore sipas PRRU “Dheu i Bardh-2” – Gjilan me 25 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan

2.11. Propozim Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Ensar Kadriu-ky plan bazohet në nenin 9 paragrafi 1.7 të Udhëzimit administrativ nr.27/2012 të MPP, 03/2012 të MPL-së si dhe nenin 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit. Ky plan ka për obligim ta vlerësojë situatën e sigurisë e të cilat mund të jenë komplekse si krimi dhe rendit publik, mungesa në qasjen e pronave private dhe publike , mbrojtja e pyjeve dhe trafiku rrugor, apo siguria në shkolla. Të gjitha këto janë pjesë e sigurisë komunale.

Izmi Zeka-i kam dy fali; këtë e ka për obligim plani, por nuk e ka për obligim drejtori, kjo është e drejtë ekskluzive e kryetarit të Komunës. Drejtori po e prezanton, nuk e kam shikuar në detale, por ky është obligim vjetor. Me ligj mund ta autorizoj kryetari edhe drejtorin.

Isa Agushi- unë në emër të grupit të LDK-së po theksoj se drejtorin e ka autorizuar kryetari për ta thënë këtë dhe në emër të grupit ne e përkrahim këtë Plan.

Pas përfundimit të debatit kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.11

Aprovohet pika 2.11: Propozim Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, me 31 vota të anëtarëve të Kuvendit, nuk kishte kundër.

2.12. Propozim Plani për ndryshimin dhe plotësimin e Planit të veprimit për transparencë, 01.Nr.016-58781 i dt.27.05.2014

Fehmi Sylejmani – parimisht dhe në parim e përkrahim këtë plan, por unë kërkoj që të ketë mirëkuptim Zyra për informim se në ndërkohë për të gjitha çka kemi propozime ose vërejtje t' i përcjellim dhe në një mënyrë t' ia japim një ndihmë edhe kësaj zyre në mënyrë që të jetë sa më i mirë ky ligj për transparencën për mos të pasur telashe në të ardhmen. Ne e përkrahim këtë plan.

Ibrahim Ademi- Plani i komunës së Gjilanit për transparencë i hartuar në bashkëpunim i përmban 15 objektiva të rëndësishme dhe si i tillë është i harmonizuar me MPL-në dhe Divizionin për Transparencë. Për herë të parë ky plan i specifikon titullarët e tij për zbatimin e secilës objektive dhe ajo që është shumë e rëndësishme për herë të parë në nivel vendi Plani për transparencë në Komunë të Gjilanit i jep hapësirë shfave të grupeve për t' i paraqitur në mënyrë institucionale qëndrimet e tyre në konferencat për media e që i organizon Zyra për informim publik.

Pas përfundim të debatit për këtë pikë, kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.12?

Aprovohet pika 2.12: Propozim Plani për ndryshimin dhe plotësimin e Planit të veprimit për transparencë, 01.Nr.016-58781 i dt.27.05.2014, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

2.13. Rishikimi i Vendimit për ndryshimin e Projektit të Lumit “Mirusha

Nuk pati sugjerime dhe vërejtje për këtë pikë të rendit të punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.13 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.13 e rendit të punës: Rishikimi i Vendimit për ndryshimin e Projektit të Lumit “Mirusha, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, të tjerët abstenuan.

Të ndryshme

Fehmi Sylejmani- unë kam dërguar shkresa para vitit të ri për të gjithë drejtorët dhe përveç që po e shoh drejtorin për Zhvillim Ekonomik, z. Zuzaku i cili ka qenë shumë ekspeditiv dhe e ka kthyer përgjigjen, kurse të tjerët asnjë nuk i kanë kthyer përgjigjet. Kërkoj nga të gjithë drejtorët që të më japin përgjigje.

Nazim Gagica – për administratën e pata një pyetje nga zonja apo zonjusha lidhur me leximin e të dhënave në gjendjen civile.Unë kam bërë kresë në MPB për qasje në të dhëna personale për vaksinimin të fëmijëve dhe mua më është dhënë leje vetëm për kioske dhe nuk më është dhënë për qasje të tjera. Ne kemi propozuar atë mjekun për vaksinim të shkojë në repartin e gjinekologjisë dhe aty i merr informatat. Përfaqësuesi i VV-së 15 minuta foli për administratë, por nuk e kuptova se a po flet për Prishtinë apo për Gjilan? Zyrat e vendit i nderuari këshilltar tani zyrat e vendit nëpër fshatra janë të lidha drejtpërdrejt me administratë.

Fatbardhë Selmani- drejtorit po i them se fatmirësisht atë digjej që e ka bërë në kanagjeqin tim e kam pasur gratis, sepse për ndryshe e kisha thirr për të kënduar dhe kishe ditë statusin tim martesor. E dyta pyetjet e mia nuk kanë qenë humoriste ashtu siç u sollët ju, sepse janë shumë qenësore, sepse nga mos vaksinimi vijnë shumë sëmurje të ndryshme. Është e vërtetë se në gjinekologji kanë qasje mjekët e vaksinimit, por aty nuk lidin vetëm gratë nga qyteti i Gjilanit, por nga regjioni, Vitia, Kamenica etj. Unë kërkoja me sinqeritet të na përgjigjesh e jo ta shndërrosh pyetjen në humor.

Nevzad Isufi- unë kam pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike dhe është fjala për hyrje daljet në qytet , sepse ka pyetje nga qytetarët se a është lëshuar plani i katër korsive, apo është menduar që të rregullohet ndonjë reth-rrrotullim te rruga e Prishtinës. Tjetra ka të bëjë me mundësinë e shërbimeve publike nëpër lagje të mëdha siç është Arbëria dhe plot lagje të tjera. Është mirë që të bëhen mini tregje të vogla të pemëve dhe perimeve nëpër lagje të tilla. Drejtorët mandej duhen t’i marrin përgjigjet edhe nga procesverballi dhe në seancën e radhës të japin përgjigje. Sa i përket kioskat të Administratës, unë vetë kam provuar të nxjerr dokument, por ai kiosk nuk ka funksionuar.

Fehmi Sylejmani - nuk po replikoj me drejtorin e Administratës, por po sqaroj dhe është e vërtetë atë që e tha drejtori se në raportin e punës kemi pasur më shumë vërejtje, këshilla dhe sugjerime e që do t’i shërbejnë në punën e tij. Nëse më ka dëgjuar mirë, unë e kam lavdëruar, sepse e kam thënë se nuk ka rend të gjatë të qytetarëve në sportelet e administratës. Unë për këtë e përgëzoj dhe e përgëzoj për atë se që nga fillimi i seancës ka qenë i pranishëm në sallë.

Leonorë Bunjaku- sot shumë gjëra u personalizuan dhe shumë emra u përmendën, por dëshiroj që këtë propozimin tim mos ta merr askush si personale ose si konflikt interesi. Unë edhe pse në të kaluarën kam jetuar në atë lagje e të cilën frekuentoj, por edhe frekuentohet shumë nga qytetarët. Çka është puna e rrugës së tregut?

Kjo është njëra ndër rrugët më të dëmtuara, kurse ne flasim për autostradë, flasim për asfaltim të rrugëve nëpër fshatra, kurse qendra e qytetit të Gjilanit nuk i bie në sy askujt. Deri kur do të bëhet së paku një riparim i vogël në atë pjesë?

Arijetë Rexhepi- unë do t' i ngris disa probleme të fshatit Gadish, sepse banorët e këtij fshati kanë disa kërkesa: Janë 34 nxënës që udhëtojnë në shkolla të mesme në Gjilan, por nuk kanë transport nga komuna dhe në mesin e tyre ka edhe fëmijë e që shkaku i kushteve e kanë ndërprerë edhe shkollimin e mesëm.

Gjithashtu në këtë fshat është premtuar ujësjellësi, kanalizimi dhe asfaltim të rrugëve, por deri më sot asgjë nuk është bërë. Ka edhe familje skamnore me shtëpi para rrënimin e që gjatë reshjeve iu hynë uji brenda.

Komuna fare nuk është interesuar për t' i ndihmuar këto familje edhe pse mund të ndihmohen nga fondi i solidaritetit, por në atë fshat askush nuk e ka bërë asnjë vizitë.

Mevludë Zejnullahu- edhe unë i kam dy pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: e par është përkitazi me bankomatin i cili gjendet te TEB banka. Ai bankomat është në një vend të papërshtatshëm dhe është ndoshta edhe rrezik për personat të cilat i tërheqin mjetet, por është edhe pengesë për kalimtarë. Jo shumë larg më ka rastis ta shoh një nënë me karrocë dhe me fëmijë nuk mund të ecte nëpër rrugë, sepse ishte krijuar një rend i madh i qytetarëve për t' i tërheq parat.

E dyta është fjala për sipërfaqen te ujësjellësi, aty është shndërruar një deponi e mbeturinave. Unë e njoh atë vend qysh moti, sepse kam lindur dhe rritur aty afër dhe e di si ka qenë ai vend përpara. Aty ka qenë park me plepa të gjatë dhe tërë gjelbërim. Tash aty nuk ka rrethoja, është shndërruar në vend me mbeturina dhe aty bëhet grumbullimi i qenve.

Me këto debate dhe vendime seanca i përfundoi punimet në ora 17.30 min.

Vërejtje : Kërkoj falje nga të gjithë anëtarët e Kuvendi që nuk kam pasur mundësi në disa pika t' i regjistroj të gjitha diskutimet, sepse vetëm pika e parë, Raporti i kryetari i ka përfshirë afër 30 faqe dhe nëse do të regjistroheshin të gjitha diskutimet ashtu siç kam vepruar gjatë tërë kohës do të ishte një procesverbal prej 60-70 faqe.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentin Bunjaku- Rexhepi